



Draft raporti në hije

Për zbatimin e Konventës të Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje në Maqedoninë e Veriut

Gusht 2021

Shënim

Ky raport ishte përgatitur nga përfaqësuesit e Platformës për barazi gjinore, dhe ka përfshirë 9 monitorues nga 8 organizata anëtare (Reaktor, Koalicioni Margini, HERA, Rrjeti nacional kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, Organizata e grave të Shën Nikollës, Tiiiiit! Inc., HOPS Dhe Rrjeti Stella të cilët kanë mbledhur të dhënat e nevojshme për këtë raport. Teksti përfundimtar i raportit ishte hartuar nga ekspertja Biljana Kotevska.

Raporti ishte përgatitur në kuadër të projektit **Ndërtimi i kapaciteteve të OSHC për të prodhuar raportin në hije të GREVIO**, të financuar nga UN Women, të cilin Komisioni I Helsinkit për të drejtat e njeriut e ka realizuar në periudhën Gusht 2020 – Shtator 2021. Aktivitetet e projektit gjithashtu kanë përfshirë ndërtimin e kapaciteteve të përfaqësuesve të OSHC me qëllim që të mbështesin koordinimin e monitorimit të zbatimit të KS dhe të përforcojnë kapacitetet e OSHC për të hartuar një raport të përbashkët në hije. Ky raport do të shërbejë si bazë për raportin përfundimtar në hije të cilin Platforma për barazi gjinore do ta përgatis dhe do t'ia dorëzojë Komitetit të GREVIO në vitin 2022, në pajtim me afatin përfundimtar të shtetit.

Ky raport është hartuar me mbështetje financiare nga Bashkimi Evropian. Përmbajtja e tij është përgjegjësi e vetme e Komitetit të Helsinkit për të Drejtat e Njeriut dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e Bashkimit Evropian. Përmbajtja e këtij raporti nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e UN Women, Këshillit ekzekutiv të saj apo Shteteve Anëtare të Kombeve të Bashkuara.



„Врати се дома и не доаѓај повеќе. Знаеш ли ти кого пријавуваш? Знаеш дека пријавата магично ќе исчезне? Најдобро е да си покутиш и да се смириш. Ќе ти помине лутината, ќе заборавиш.“

[Kthehu në shtëpi dhe mos eja sërish. A e di se cilin e paraqet? A e di se paraqitja do të zhduket në mënyrë magjike? Më mirë është të heshtësh dhe të pajtoheni. Do të kalojë mëria, do harrosh.]¹

„ Не можеме да преземеме интервенција во конкретниот случај, бидејќи сторителот е позитивен на КОВИД-19.“

[Nuk mund të ndërhyjmë në rastin konkret, sepse kryerësi është pozitiv me KOVID-19.]²

„Судијата упати зборови према детето ‘Оди гушни го татко ти’“.

[Gjykatësi i tha fëmijës "Shko përqafo babain tënd ".]³

¹ Këshilla e policit ndaj një gruaje që raporton dhunën në familje. Media ka raportuar tregimin e viktimës. Burimi: Aleksandra Spaseska, “Пријавување родово базирано насилство: Колку пати жртвата ја преживува траумата?” [Sa herë viktimata ka përjetuar traumën?], *kajgana.mk*, <https://kajgana.com/prijavuvane-rodovo-bazirano-nasilstvo-kolku-pati-zhrtvata-ja-prezhivuva-traumata>.

² Përgjigjja nga policia në kërkesën për intervenim nga viktimata e dhunës në familje (siç është raportuar nga OJQ Shoqata e juristëve të rinj maqedonas). SDK, “Тетовчанка молела за помош додека ја тепал сопругот, полицијата не интервенирала оти бил позитивен на корона вирус” [Gruaja në Tetovë ka lutur për ndihmë derisa e ka rrahur bashkëshorti, policia nuk ka intervnuar sepse ka qënë pozitiv me virusin korona], *sdk.mk*, Burimi: https://sdk.mk/index.php/neraskazhani-prikazni/tetovchanka-molela-za-pomosh-dodeka-ja-tepal-soprugot-politsijata-ne-intervenirala-oti-bil-pozitiven-na-koronavirus/?fbclid=IwAR2Sj8LKbqobnLK2_ZY0Hyxq2GG9TmPjJOUhD7HNwHUuUd28MMW4wluJef7E.

³ Fëmija është një vajzë tetë vjeçare, viktimë e dhunës në familje. Babai është shpallur fajtor. Burimi: KOD, *Semejno nasilstvo i Swarovski korupcija 23.06.2019* [Dhuna në familje dhe Korupsioni Swarovski 23.06.2019], <https://www.youtube.com/watch?v=042jrn9hovk>



Tabela e përmbajtjes

LISTA E SHKURTESAVE	5
HYRJE	6
I – QËLLIMET, PËRKUFIZIMET, BARAZIA DHE MOSDISKRIMINIMI, DETYRIMET E PËRGJITHSHME	9
NENI 3 – PËRKUFIZIMET	9
NENI 4 – TË DREJTAT THEMELORE, BARAZIA DHE MOSDISKRIMINIMI	12
II – POLITIKAT E INTEGRUARA DHE MBLEDHJA E TË DHËNAVE	13
NENI 7 – POLITIKAT GJITHËPËRFSHIRËSE DHE TË KOORDINUARA	13
NENI 9 – ORGANIZATAT JOQEVERITARE DHE SHOQËRIA CIVILE	18
NENI 11 – MBLEDHJA E TË DHËNAVE DHE HULUMTIMI	20
III – MBROJTJA DHE MBËSHTETJA	32
NENI 20 – SHËRBIMET E PËRGJITHSHME TË MBËSHTETJES	32
NENI 22 – SHËRBIMET E SPECIALIZUARA PËR MBËSHTETJE	39
NENI 23 – STREHIMORET	40
NENI 24 – LINJAT NDIHMËSE TELEFONIKE	41
NENI 25 – MBËSHTETJE PËR VIKTIMAT E DHUNËS NË FAMILIE	42
IV – E DREJTAT MATERIALE (SUBSTANCIALE)	42
NENI 29 – PADITË CIVILE DHE MJETET JURIDIKE	42
NENI 30 – KOMPENZIMI	43
NENI 33 – DHUNA PSIKOLOGJIKE	45
NENI 34 – NDJEKJA	45
NENI 35 – DHUNA FIZIKE	46
NENI 36 – DHUNA SEKSUALE DUKE PËRFSHIRË PËRDHUNIMIN	47
NENI 37 – MARTESAT E DETYRUESHME	48
NENI 38 – GJYMTIMI GJENITAL FEMËROR	49
NENI 39 – ABORTI I DETYRUESHËM DHE STERILIZIMI I DETYRUESHËM	49
NENI 40 – NGACMIMI SEKSUAL	50
NENI 41 – NDIHMA OSE NXITJA DHE TENTATIVA	51
NENI 43 – KRYERJA E VEPRAVE PENALE	51
NENI 45 – SANKSIONET DHE MASAT	52
NENI 46 – RRETHANAT RËNDUESE	53
NENI 48 – NDALIMI I PROCEDURAVE APO SANKSIONEVE TË DETYRUESHME PËR ZGJIDHJEN ALTERNATIVE TË KONTESTEVE	53



Lista e shkurtesave

2014 Ligji DHF, ligji i vjetër	Ligji për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna në familje
CEDAW	Konventa për eliminimin e të gjithë formave të diskriminimit kundër grave
OSHC	Organizatat e shoqërisë civile
DHF	Dhuna në familje
DHBGJ	Dhuna e bazuar në gjini
Ligji DHBGJ, ligji i ri	Ligji për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna kundër grave dhe dhuna në familje
Konventa e Stambollit, KS	Konventa e Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje
LPMD, LKD	Ligji për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi (2021)
MPS	Ministria e Punës dhe Politikës Sociale
MPB	Ministria e Punëve të Brendshme
PNV	Plani i Veprimit për Zbatimin e Konventës për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna kundër grave dhe dhunës ndaj grave në Republikën e Maqedonisë së Veriut 2018-2023
Maqedonia e Veriut, MKD	Republika e Maqedonisë së Veriut
DHNG	Dhuna ndaj grave

Hyrje

“Dhuna ndaj grave është një fenomen që është shpërndarë në mënyrë të konsideruar në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Tre nga pesë (60%) gra konsiderojnë se dhuna ndaj grave është e zakonshme, ndërsa tre nga dhjetë konsiderojnë se është e shpeshtë. Pothuajse një nga pesë gra (17%) njih personalisht dikë në familjen e saj dhe në mes të miqve të saj që ka vuajtur një formë të dhunës në familje.” Strategjia për barazinë gjinore 2021-2026, fq.19.⁴

Dhuna e bazuar në gjini (DHBGJ) dhe dhuna në familje (DHF) është një nga sfidat më të mëdha sociale, të rrënjosura më thellë për të drejtat e grave dhe për zhvillimin e përgjithshëm shoqëror në Republikën e Maqedonisë së Veriut. (Maqedonia e Veriut). Dhe, ende, pas nënshkrimit të Konventës të Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje (Konventa e Stambollit) në vitin in 2011, Maqedonisë së Veriut i duheshin shtatë vite dhe lobim dhe fushatë domethënëse nga organizatat e shoqërisë civile (OSHC)⁵ për ta ratifikuar atë. Ratifikimi ka ndodhur në 23 mars të vitit 2029, dhe që nga 01 korriku i vitit 2018 Konventa ka hyrë në fuqi.⁶ Ngurrimi i gjatë për të bërë këtë traktat ndërkombëtar historik, ligj të vendit, ishte pasqyrim i qartë i partiarkatit të rrënjosur thellë i mbivendosur në sundimin jodemokratik të qeverisë që ishte gjithnjë e më armiqësor ndaj të drejtave të grave.⁷ Vetëm pasiqë ndodhi ndryshimi në qeveri në vitin 2017 ka ndryshuar kjo valë duke mundësuar përfundimisht që Konventa e Stambollit të bëhet pjesë e sistemit nacional ligjor në pajtim me nenin 118 të Kushtetutës të Maqedonisë së Veriut.⁸

Duke qëndruar të mbërthyer nën mbulesën e stigmës, tabuve dhe turpit edhe pas dekadëve pasiqë ishte deklaruar barazia e grave dhe burrave dhe të drejtat e grave ishin njohur me ligjin nacional,⁹ DHBGJ dhe DHF kanë vazhduar dhe janë ngulitur dhe normalizuar në shoqërinë maqedonase. Kjo rezistencë e gjatë drejtë miratimit të një kornize nacionale ligjore për të luftuar DHBGJ dhe DHF kanë kultivuar një klimë të mos-raportimit, mohimit dhe mos-njohjes të DHBGJ, DHF, specifikave të tyre dhe natyrës të veçantë. Vetëm me nënshkrimin e Konventës të Stambollit në vitin 2014 dhe ligjin e parë mbi DHF të miratuar në vitin 2014

⁴ Ju lutemi vini re në kohën e shkrimit të këtij raporti në hije (teksti është mbyllur në 10.08.2021) Strategjia ishte miratuar nga Qeveria, por nuk ishte miratuar nga Parlamenti.

⁵ Shihni, për shembull, fushatën “Potpišuvam”: <https://www.potpisuvam.org/mk/campaign.html>.

⁶ Këshilli i Evropës, *Chart of signatures and ratifications of Treaty 210*, CoE Treaty Office, <https://www.coe.int/en/web/conventions/full-list/-/conventions/rms/090000168008482e?module=signatures-by-treaty&treatynum=210>.

⁷ Shihni, për shembull: Ana Miškovska Kajevska, ‘Suspending Democracy, Harming Gender Equality’ in Mieke Verloo (ed), *Varieties of opposition to gender equality in Europe* (Routledge, Taylor & Francis Group 2018).

⁸ Устав на Република Македонија [Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë së Veriut], *Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut*, Nr.52/1991; 1/1992; 1/1992; 31/1998; 31/1998; 91/2001; 91/2001; 84/2003; 84/2003; 107/2005; 107/2005; 3/2009; 3/2009; 13/2009; 49/2011; 49/2011; 6/2019; 6/2019; Neni118.

⁹ Устав на Народна Република Македонија [Kushtetuta e Republikës Popullore të Maqedonisë], *Gazeta Zyrtare e Republikës Popullore të Maqedonisë*, Nr.1/1947, Nenet 22(1) dhe 23.

– Ligji për prandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna në familje (Ligji DHF i vitit 2014, ligji i vjetër)¹⁰ – që shteti filloi të bëj hapat e vegjël, edhe pse të pavendosur dhe shumë të dobët, drejtë trajtimit të DHBGJ dhe DHF. Megjithatë ende, ne mund të flasim për ekzistencën e kornizës ligjore nacionale për DHBGJ dhe DHF vetëm pas ratifikimit të Konventës të Stambollit dhe miratimit të Ligjit për prandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna ndaj grave dhe dhuna në familje në vitin 2021 (Ligji DHBGJ, ligji i ri).¹¹

Rezultati kryesor i këtij mosveprimi të gjatë legjislativ shtetëror është natyra e përhapur e DHBGJ dhe DHF në vend. Për qëllime të ilustrimit, në vitin 2019, gjithsej 989 raste në lidhje me dhunën në familje ishin raportuar në Ministrinë e Punëve të Brendshme (MPB), prej të cilave 588 ishin lëndime fizike, 23 me lëndime të vogla, 366 për rrezikimin e sigurisë dhe pesë femicide. Në vitin e njëjtë, Ministria e Punës dhe Politikës Sociale (MPPS), ka regjistruar 1555 raste të reja të DHF me 1135 gra viktime/ të mbijetuara dhe 173 fëmijë viktime/të mbijetuar. Në vitin 2019 hulumtimi rajonal i Ballkanit Perëndimor për avokatët e të drejtave të njeriut, gratë avokate të të drejtave të njeriut në Maqedoninë e Veriut kanë ndarë përvoja personale të ngacmimit seksual, kërcënimeve të dhunës fizike dhe përdhunimit, dhe sulme fizike gjatë ngjarjeve femërore, që kishte kaluar pa veprimin e institucioneve relevante të cilët ishin perceptuar se “nuk i marrin seriozisht në konsideratë krimet të cilat ishin kryer kundër grave”.¹² Në gjysmën e parë të vitit 2020, Ministria e punëve të brendshme ka regjistruar 6 vrasje të lidhura me DHF (krahasuar me vitin 2019).¹³ “Nuk kishte një rritje domethënëse në numrin e veprave penale që lidhen me dhunën në familje në gjysmën e parë të vitit 2020 (435) krahasuar me periudhën e njëjtë në vitin 2019 (433). Megjithatë, ishte regjistruar një rritje prej 18% në numrin e raporteve që lidhen me dhunën në familje për periudhën Janar-Qershor 2020 (1874), krahasuar me të njëjtën periudhë në vitin 2019 (1541). 65% e viktimave ishin gra, dhe numri më i lartë i sulmeve ndaj grave viktime ishin kryer nga partneri aktual apo partneri i mëparshëm.”¹⁴

Pasi ratifikimit të Konventës të Stambollit, autorët e këtij raporti kanë filluar që të monitorojnë rregullisht zbatimin e saj. Ky raport në hije është rezultat i atij efekti të monitorimit. Ne kemi hartuar një pyetësor dhe një matricë të monitorimit dhe kemi grumbulluar të dhënat gjatë muajve maj, qershor dhe korrik të vitit 2021. Ne jemi mbështetur në disa burime të të dhënave: (1) informata dhe burime publikisht të disponueshme (të mbledhura përmes hulumtimit), (2) intervista me palët kryesore të përfshira (të realizuara gjatë periudhës të njëjtë në formën e strukturuar; të referencuar në këtë raport), (3) kërkesat

¹⁰ Закон за превенција, спречување и заштита од семејно насилство [Ligji për prandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna në familje], *Gazeta Zyrtare e Republikës të Maqedonisë së Veriut*, Nr. 33/2015; 150/2015.

¹¹ Закон за спречување и заштita од насилство врз жените и семејното насилство [Ligji për prandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna ndaj grave dhe dhuna në familje], *Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë*, Nr.24/2021.

¹² Biljana Kotevska dhe Ismail Kamberi, “Maqedonia e Veriut”, in Biljana Kotevska (ed), *Human Rights Defenders in the Western Balkans: Intimidation Instead of Recognition* (Civil Rights Defenders, 2019), 68, 76, 79.

¹³ Departamenti për marrëdhënie publike dhe çështje strategjike – Sektori për Marrëdhënie Publike dhe Protokoll (Оддел за односи со јавност и стратешки прашања (Сектор за односи со јавност и протокол), ‘(Решение за одговор на Барање за слободен пристап до информации од јавен карактер)’ (Ministria e punëve të brendshme (Министерство за внатрешни работи), 11 August 2020). Siç është cituar në: Biljana Kotevska et al, “Franet National contribution to the Fundamental Rights Report 2021 - Republic of North Macedonia”, *europa.eu*, https://fra.europa.eu/sites/default/files/fra_uploads/frr2021_north_macedonia-frr2021_en.pdf.

¹⁴ Biljana Kotevska et al, “Franet National contribution to the Fundamental Rights Report 2021 - Republic of North Macedonia”, *europa.eu*, https://fra.europa.eu/sites/default/files/fra_uploads/frr2021_north_macedonia-frr2021_en.pdf (citohet: Departamenti për marrëdhënie publike dhe çështje strategjike - Sektori për marrëdhënie publike dhe protokoll (Оддел за односи со јавност и стратешки прашања (Сектор за односи со јавност и протокол), ‘(Решение за одговор на Барање за слободен пристап до информации од јавен карактер)’ (Ministria e punëve të brendshme (Министерство за внатрешни работи), 11 Gusht, 2020)).



për qasje në informata publike (të dërguara në periudhën e theksuar më herët; të referencuara në këtë raport), dhe (4) (ri)përdorimi i të dhënave që organizata jonë ka mbledhur për DHBGJ dhe DHF në vitet e kaluara (ku (ri) përdorimi i tillë ishte i mundur kur vlerësohej kundrejt standardeve etike dhe të privatësisë).

Në këtë raport në hije, ne ofrojmë informata për nenet e përzgjedhura,¹⁵ në pajtim me fushëveprimin e punës tonë. Kështu, raporti nuk mbulon të gjithë tekstin e konventës. Sfida më e madhe për përgatitjen e këtij raporti ishte mungesa e të dhënave dhe rastësia e përgjithshme me të cilën trajtohet çështje e DHBGJ dhe DHF kur bëhet fjalë për mbledhjen respektivisht grumbullimin e të dhënave nga institucionet shtetërore. Ne e diskutojmë këtë në më shumë detaje në raportin tonë në nenin 11. Përveç kësaj, raporti do të përfitonte nga përgatitja në një kornizë më të gjatë kohore për të lehtësuar nxjerrjen e maksimumimit nga këto metoda për grumbullimin e të dhënave, që është më e rëndësishme për kërkesat për qasje në informata publike, të cilat merrnin më shumë kohë. Mungesa e përgjigjes respektivisht reagimit të disa institucioneve në kërkesat tona për informacione ishte një ngarkesë shtesë. Përfundimisht, përfundimi i monitorimit për të gjithë vitin 2021 do të ishte shumë përftues, duke marrë parasysh kornizën kohore të parashikuar për atë se kur Maqedonia e Veriut do të pranojë pyetësin e GREVIO.

¹⁵ Për një listë të plotë të neneve të mbuluara nga ky raport në hije, ju lutemi konsultoni Tabelën e Përmbajtjes.

I – Qëllimet, përkufizimet, barazia dhe mosdiskriminimi, detyrimet e përgjithshme

Neni 3 – Përkufizimet

Ligji për DHBGJ përfshin përkufizimet për “dhunën ndaj grave”, “gjininë”, “dhunën e bazuar në gjini ndaj grave”, “viktimën” dhe “gratë” (Neni 3).¹⁶ Këto janë përsëritur nga Konventa e Stambollit dhe rrjedhimisht janë tërësisht në pajtim me të. Megjithatë, është me rëndësi të theksojmë se Kodi Penal ofron një përkufizim pak ndryshe për “viktimën”. Sipas Neni 122(22), viktimë është “çdo person që ka vuajtur ndonjë dëm, duke përfshirë lëndimet fizike apo mendore, vuajtjes emocionale, humbje materiale apo shkelje tjetër apo rrezikim të të drejtave dhe lirive themelore si pasojë e veprës penale.”¹⁷ Përderisa ky përkufizim nuk përfshin shprehimisht të gjithë elementet e Neni 3, paragrafet a dhe b të Konventës të Stambollit, nëse dikush merr parasysh se elementet kryesore të tij janë “çdo person”, “që ka përjetuar lëndim”, dhe “si pasojë e veprës penale” mund të konsiderohet se nuk është në kundërshtim me atë në Konventë.

Përkufizimi i “dhunës në familje” të përfshirë në Nenin 3(3) të Ligjit për DHBGJ është përsëritur nga përkufizimi i “dhunës në familje” në Kodin Penal. Neni 122 (21) i Kodit Penal përkufizon DHF si “ngacmim ofendim, rrezikim të sigurisë, lëndim trupor, seksual apo dhunë tjetër psikologjike, fizike apo ekonomike që shkakton ndjenjën e pasigurisë, kërcënimit apo frikës, duke përfshirë kërcënimet e veprimeve të tilla drejtë bashkëshortes, prindërve apo fëmijëve apo personave tjerë që jetojnë në bashkësinë martesore apo jashtëmartesore apo në pronësinë e përbashkët, si dhe drejtë bashkëshortes të mëparshme apo jashtëmartesore apo personave që kanë fëmijë të përbashkët apo janë në marrëdhënie të ngushtë personale, pavarësisht nëse kryerësi ndan apo ka ndarë apo jo shtëpinë e njëjtë me viktimën”.¹⁸ Terminologjia nuk përputhet me atë të Konventës të Stambollit. Do të kërkojë interpretim gjyqësor për të siguruar se fushëveprimi i neni të Kodit Penal nuk do të konsiderohet se është më i ngushtë se ai në Nenin 3 (b) të Konventës të Stambollit në aspekt të llojeve të dhunës të cilat janë inkriminuar. Përveç kësaj, “kjo shkakton ndjenjën e pasigurisë, kërcënimit apo frikës” mund të interpretohet si një element shtesë që duhet të përmbushet para gjykatës; një element i tillë nuk është i pranishëm në Nenin 3(b) të Konventës të Stambollit.

Megjithatë, duhet të theksohet se, duke patur parasysh miratimin e fundit të ligjit për DHBGJ dhe periudhën e gjatë kohore që sistemi gjyqësor po procedonte rastet e DHBGJ dhe DHF sipas kornizës të vjetër ligjore, është e pritshme se do të ketë sfida në vendosjen e këtyre përkufizimeve në praktik. Sipas hulumtimit të

¹⁶ Në Nenin 3 të Ligjit për DHBGJ gjithashtu përfshihen përkufizimet “marrëdhënie të ngushta personale”, “person transgjini”, “kryerës”, “dhuna nga partneri intim”, “dhuna fizike”, “dhuna psikologjike”, “ndjekja”, “dhuna ekonomike”, “dhuna seksuale dhe përdhunimi”, “ngacmimi seksual”, “ngacmimi seksual përmes internetit”, “martesa e detyrueshme”, “gjymtimi gjenital femëror”, “abortimi i detyrueshëm dhe sterilizimi i detyrueshëm”, “trafikimi i grave”, “kontrolli i detyrueshëm mbi gratë”. Burimi: Закон за спречување и заштита од насилство врз жените и семејното насилство [Ligji për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna ndaj grave dhe dhuna në familje], *Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut*, Nr.24/2021. Neni.3.

¹⁷ Кривичен законик [Kodi Penal], *Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë*, Nr. 80/1999; 48/2001; 4/2002; 16/2002; 43/2003; 19/2004; 40/2004; 81/2005; 50/2006; 60/2006; 73/2006; 87/2007; 7/2008; 139/2008; 114/2009; 51/2011; 51/2011; 135/2011; 185/2011; 142/2012; 143/2012; 166/2012; 55/2013; 82/2013; 14/2014; 27/2014; 28/2014; 41/2014; 41/2014; 115/2014; 132/2014; 160/2014; 199/2014; 196/2015; 226/2015; 97/2017; 170/2017; 248/2018. Neni.122(22).

¹⁸ Po aty. Neni122(21).



mëparshëm para ligjit për DHBGJ, përmban informacion të vlefshëm për kulturën gjyqësore në vend dhe sfidat e mundshme që mund të priten dhe të cilat mund të shërbejnë si udhërrëfyes për përshtatjen e mëtutjeshme të aktiviteteve të shtetit si palë. Për shembull, një fokus grup me juristët që kanë sjellur rastet e DHF para gjykatës të realizuar kuadër të një analizë të vitit 2019 të zbrazëtirave të Kodit Penal krahasuar me Konventën e Stambollit ka sjellur më shumë informata për këtë, pavarësisht kornizës ligjore në pjetim me të drejtat procedurale dhe të drejtat tjera të viktimës, në praktikë, të drejtat e viktimës “janë rrezikuar gjithashtu nga mungesa e vetëdijes dhe njohurisë të gjykatësve, në veçanti të gjykatësve që janë të gjinisë mashkullore, të cilët nuk e shohin dhunën në familje apo dhunën me bazë gjinore, dhe në vend se të ndërmerren procedura gjyqësore në një mënyrë të paanshme dhe në pajtim me procedurat gjyqësore, ata përpiqen që të ndërmjetësojnë dhe të pajtojnë partnerët dhe të japin këshilla për viktimat që të kthehen në shtëpinë e kryerësit.”¹⁹ Kjo ishte konfirmuar në vëzhgimet e fundit përfundimtare për CEDAW,²⁰ dhe në *S.B. dhe M.B. kundër Maqedonisë së Veriut*, ku Komisioni i CEDAW ka rekomanduar këtë: “Rritja e vetëdijes të gjykatësve për modiskriminimin, duke përfshirë aspektet procedurale të zhvendosjes të barrës të dëshmisë gjatë procedurave gjyqësore; dhe të sigurohet se gratë kanë të drejtën në mjete juridike efektive, të përballeshme, të qasshme dhe në kohë, të adresohen në shqyrtim të drejtë nga gjykata apo tribunali kompetent dhe i pavarur, ku është e mundur, apo nga institucionet tjera publike, duke marrë parasysh Rekomandimet e përgjithshme të Komisionit nr. 33 mbi qasjen e grave në drejtësi.”²¹

Përderisa DHBGJ sjell disa risi të cilat duhet të ndiqen nga gjykatësit, është e theksuar mire në literaturë se është shumë e vështirë që të ndryshohet kultura gjyqësore dhe bën pjesë në narrativa dhe modele të “traditës” të cilat vështirë se mund të thyhen. Rrjedhimisht do të duhen përpjekje domethënëse për të siguruar zbatimin e duhur të këtyre përkufizimeve në praktikë. Plani i Veprimit për zbatimin e Konventës për parandalimin dhe luftimin kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje në Republikën e Maqedonisë 2018-2023 (PNV) është një hap në drejtimin e duhur. Ky përfshin gjykatësit dhe prokurorët publik ndërmjet profesionistëve të cilët veprojnë në fusha të ndryshme të jetës profesionale dhe sociale, pavarësisht nëse ata ofrojnë drejtëpërdrejtë shërbime për viktimat e DHBGJ dhe DHF. Kjo gjithashtu përfshin ndërmarrjen e trajnimit të përgjithshëm për DHBGJ për gjykatësit dhe prokurorët publik me Akademinë për Gjykatës dhe Prokurorë Publik përmes moduleve për gjykatësit dhe prokurorët publik.²² Megjithatë, këto nuk ishin zbatuar në kuadër të afatit të fundit të planifikuar (fundi i vitit 2019) dhe ishin shtyrë për vitin 2021.²³ Strategjia e re për barazinë gjinore 2021-2026 përmend nevojën për “senzibilizimin

¹⁹ Marija Risteska and Aleksandar Cekov, *Анализа на потребите од усогласување на Кривичниот законик со Истанбулската конвенција во Република Северна Македонија* [Analiza e nevojave për harmonizimin e Kodit Penal me Konventën e Stambollit në Republikën e Maqedonisë së Veriut], (Qendra për hulumtim dhe krijimin e politikave dhe Lobi i femrave maqedonase, 2019), 16.

²⁰ Komisioni mbi eliminimin e diskriminimit ndaj grave, *Vëzhgimet përfundimtare për raportin e gjashtë periodik të ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë CEDAW/C/MKD/CO/6* (14.11.2018), para.13(b).

²¹ CEDAW, *Pikëpamjet e miratuara nga Komisioni sipas nenit 7 (3) të Protokollit Opcional, në lidhje me Komunikimin Nr. 143/2019 - S.B. dhe M.B. kundër Maqedonisë së Veriut* https://tbinternet.ohchr.org/Treaties/CEDAW/Shared%20Documents/MKD/CEDAW_C_77_D_143_2019_32193_E.docx.

²² Ministria e Punës dhe Politikës Sociale, *Акциски план за спроведување на Конвенцијата за спречување и борба против nasilstvoto врз жените и семејното nasilstvo на Република Македонија 2018-2023* [Plani i Veprimit për zbatimin e Konventës për parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje në Republikën e Maqedonisë 2018-2023], <https://mtsp.gov.mk/content/word/oglasi/New%20node/Финал%20драфт%20НАП%20ИК%202018-2023.02.docx>, 12, 35-36.

²³ Maja Balshikjeska dhe Ana Avramovska Nushkova, *Извештај за напредокот на Р. Северна Македонија при спроведувањето на Националниот акциски план за имплементација на Истанбулската конвенција - октомври 2018 -*



e praktikantëve ligjor mbi çështjet e barazisë gjinore për shkak të mundësisë për viktimizimin dhe diskriminimin dytësorë të personave nga grupet e rrezikuara me të cilët ata vijnë në kontakt të drejtëpërdrejtë".²⁴ Megjithatë, për dallim nga PNV, nuk e përkufizon qartë natyrën e thellë të diskriminimit gjinor dhe paragjykimin ndërmjet praktikantëve ligjor në përgjithësi dhe në gjyqësor në veçanti. Më tutje, në pjesën e DHBGJ nuk përmendet kjo sfidë.²⁵ Megjithatë, përfshin "reagim të avancuar institucional për parandalim dhe mbrojtje nga DHBGJ, sidomos nga policia dhe gjyqësori", që lidhet me trajnimet e rregullta për "punëtorët në institucione" dhe "numrin e nëpunësve administrativ që kanë kaluar trajnimin".²⁶ Megjithatë, kjo sërish nuk synon në mënyrë specifike gjykatësit dhe prokurorët publik. Përveç asaj, synimi i përgjithshëm specifik i 3.1. "Parandalimi dhe lufta kundër dhunës me bazë gjinore" nuk përfshin rezultatet apo aktivitetet që lidhen me praktikantët tjerë ligjor apo punën me shoqatat profesionale të gjykatësve dhe prokurorëve publik dhe juristëve. Gjithashtu nuk parashihet ndonjë bashkëpunim me universitetet që kanë fakultete juridike në aspekt të zhvillimit të kurseve apo përfshirjen e risive nga Konventa e Stambollit dhe Ligji për DHBGJ si pjesë e programit të tyre.

Rekomandime:

- Të rishikohet përkufizimi i "dhunës në familje" në Kodin Penal dhe Ligjin për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna ndaj grave dhe dhuna në familje me qëllim që të jetë tërësisht në pajtim me Konventën e Stambollit dhe të mos ngarkojë atë elemente shtesë.
- Të ndërmerren trajnime gjithëpërfshirëse dhe sistematike të gjykatësve dhe prokurorëve publik mbi risitë e sjellura nga Ligji për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna kundër grave dhe dhuna në familje dhe Konventa e Stambollit, duke përfshirë risitë në lidhje me natyrën dhe fushëveprimin e përkufizimeve të Nenit 3. Ky aktivitet do të ndërmerret më së miri në bashkëpunim me Akademinë për gjykatës dhe prokuror publik siç është paraparë tashmë me PNV, por duhet të integrohet në "trajnimin fillestar" dhe në "zhvillimin e vazhdueshëm profesional" (për gjykatësit dhe prokurorët publik, dhe administratën).
- Siguroni se trajnimi për gjykatës dhe prokurorë publik përfshin adresimin e formave të shumëfishta dhe ndërseksionale të diskriminimit, dhe rëndësinë e tij për DHBGJ dhe DHF.
- Nxisni dhe mbështesni bashkëpunimet me/ndërmjet universiteteve të cilat kanë fakultete juridike për zhvillimin /përshtatjen e kurseve /moduleve për të përfshirë risitë nga Konventa e Stambollit dhe Ligji për DHBGJ si pjesë e planprogrameve të tyre, duke përfshirë risitë në lidhje me natyrën dhe fushëveprimin e përkufizimeve të Nenit 3.

октомври 2020 [Raporti i progresit mbi zbatimin e Planit nacional të veprimit për zbatimin e Konventës të Stambollit në Maqedoninë e Veriut - Tetor 2018 - Tetor 2020], (Rrjeti nacional për t'i dhënë fund dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, 2020), <http://www.glasprotivnasilstvo.org.mk/wp-content/uploads/2021/02/NAP-finalen.pdf>, 28.

²⁴ Стратегија за родова еднаквост 2021-2026 [Strategjia për barazi gjinore 2021-2026] (2021), 25.

²⁵ По аты, 19-20.

²⁶ По аты, 40.



Neni 4 – Të drejtat themelore, barazia dhe mosdiskriminimi

Paragrafi 1 i Nenit 4 Konventës të Stambollit deri në një shkallë është pasqyruar në synimin e ligjit për DHBGJ të vendosur në Nenin 2 (që vendos mosdiskriminimin si parim të përgjithshëm). Neni 2 i Ligjit të DHBGJ thekson se synimi është “parandalimi i dhunës me bazë gjinore ndaj grave dhe dhunës në familje, mbrojtjes efektive të viktimave të çdo forme të dhunës me bazë gjinore ndaj grave dhe viktimave të dhunës në familje në lidhje me liritë dhe të drejtat themelore të njeriut të garantuara me Kushtetutën e Republikës të Maqedonisë së Veriut dhe marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara në pajtim me Kushtetutën. Qëllimi i ligjit është bazuar në parimin e barazisë dhe eliminimit të paragjykimeve për rolet gjinore.”

Sa i përket Nenit 4, Paragrafi 2, i Konventës të Stambollit, mund të konsiderohet si i përmbushur me dy përjashtime. Së pari, elementi i ndërmarrjes të masave të nevojshme legjislative dhe masat tjera “pa shtyrje” është në pikëpyetje. Elementi i “heqjes të ligjeve dhe praktikave që diskriminojnë kundër grave” ende nuk është përmbushur. Neni 46 i Ligjit për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi e parasheh ndërmarrjen e detyrimit për një proces të harmonizimit të brendshëm të legjislacionit nacional. Megjithatë, ky detyrim është përshkruar vetëm për instancat ku nuk ka dispozita për mosdiskriminimin, por duhet të përfshijë dispozita të tilla, dhe për më tepër, përjashton ligjet që përfshijnë dispozitat që janë diskriminuese kundër grave. Përfundimisht, ky do të jetë një hap në drejtim të duhur drejtë shfuqizimit të ligjeve. Një veprim i veçantë duhet të ndërmerret drejtë heqjes të praktikave që diskriminojnë kundër grave. Strategjia për barazinë gjinore 2021-2026 e përfshin si synim të caktuar “3.2. Luftimi i paragjykimeve gjinore dhe seksizmit dhe promovimi i barazisë”. Megjithatë, ajo përfshin një numër dhe fushëveprim shumë të kufizuar të aktiviteteve që janë kryesisht të fokusuar në media, sporte dhe arsim. Ndryshimi më i përgjithshëm dhe sistematik mund të vijë nga 3.2.6 që lidh strategjinë me detyrimin publik për barazi që ekziston sipas Ligjit për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi. Por, treguesi tregon se kjo gjithashtu nuk është menduar si veprim sistemor për çrrënjosjen e praktikave diskriminuese kundër grave, meqënëse fokusohet në monitorimin dhe zbatimin e kësaj detyre për Ligjin mbi parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi dhe udhëzimet për obligimin e sektorit publik për promovimin e barazisë dhe mosdiskriminimit. Rrjedhimisht, dokumentit të ri strategjik i mungojnë synimet dhe rezultatet e planifikimit që mund të kenë një efekt të vërtetë transformues në shoqëri dhe që mund të punojnë drejtë heqjes të praktikave diskriminuese drejtë grave.

Paragrafet 3 dhe 4 të Nenit 4 të Konventës të Stambollit janë të mbuluara me Nenin 5 të Ligjit për DHBGJ që vendos parimin e mosdiskriminimit si parim të përgjithshëm të ligjit për DHBGJ. Paragrafi 3 i Nenit 5 të Ligjit për DHBGJ pasqyron paragrafin 3 të Nenit 4 të Konventës të Stambollit. Ai përfshin, megjithatë, bazat për diskriminim nga Ligji për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi. Përderisa kjo shton disa baza të cilat nuk janë përfshirë në Konventën e Stambollit, nuk përfshin shprehimisht “lindjen” dhe “statusin e migrantëve apo refugjatëve”. Megjithatë, këto baza mund të lexohen në fushëveprimin e bazave tjera, siç janë “statusi personal apo statusi tjetër social”, “shtetësia” apo “statusi social”.²⁷

Për më tepër, kjo dispozitë është e hpaur, kështuqë bazat mund të lexohen nën “apo çfarëdo baze”. Gjithashtu është me rëndësi të theksohet se paragrafi 1 i Nenit 5 të Ligjit për DHBGJ proklamonte se “dhuna

²⁷ Udhërrëfyes mbi bazat e diskriminimit të (trupit të sapoformuar) Komisionit për mbrojtjen kundër diskriminimit konfirmon se ky do të jetë rasti I tillë. Burimi: Biljana Kotevska, *Udhërrëfyes mbi bazat e diskriminimit* (Organizata për siguri dhe bashkëpunim në Evropë – Misioni në Shkup dhe Komisioni për mbrojtje nga diskriminimi, 2013).



me bazë gjinore ndaj grave është diskriminim ndaj grave që i kufizon ata në gëzimin e të drejtave dhe lirive në nivel të barabartë me burrat.” Paragrafi 4 i Nenit 5 të Ligjit për DHBGJ përputhet me paragrafin 4 të Nenit 4 të Konventës të Stambollit.

Rekomandimet:

- Të ndryshoet Strategjia nacionale për barazinë gjinore për të përfshirë rezultatet e pritura që do të jenë më sistemore dhe do të luftojnë me potencialin transformues të parimit të barazisë drejtë çrrënjësjes të praktikave diskriminuese drejtë grave.
- Të interpretohet dhe zbatohet Neni 46 i Ligjit për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi për të përfshirë edhe ligjet të cilët nuk përmbajnë dispozita mosdiskriminuese, por duhet të përfshijnë dispozita të tilla, dhe ligje që përfshijnë dispozita që janë diskriminuese në bazë të gjinisë.

II – Politikat e integruara dhe mbledhja e të dhënave

Neni 7 – Politikat gjithëpërfshirëse dhe të koordinuara

Nuk mund të thuhet se Maqedonia e Veriut ka përmbushur obligimet e saj sipas Nenit 7 të Konventës të Stambollit. Siç po diskutojmë në këtë pjesë, edhe pse PNV si dokument në vete ofron bazë të mirë për zbatimin e Konventës të Stambollit, zbatimi i saj i penguar dhe mungesa e përpjekjeve të vazhdueshme, të qëndrueshme dhe të koordinuara ndërmjet të gjithë agjencive, institucioneve dhe organizatave relevante rezultojnë në mungesë të përparimit në rrafsh që rrënon gjithashtu përpjekjet e disa aktorëve që janë përpjekur që të përmbushin detyrimet e tyre për PNV, siç janë Ministria e Punës dhe Politikës Sociale. Përfundimisht, ka vetëm përpjekje rudimentare, shpesh të papërshtatshme për përfshirjen e organizatave të shoqërisë civile, sipas paragrafit 3 të Nenit 7 të Konventës të Stambollit.

Mbrojtja ndaj të gjithë formave të DHBGJ është pjesë e Planit Strategjik të Ministrisë të Punës dhe Politikës Sociale si objektiv prioritar në kuadër të Programit të Ministrisë për mundësi të barabarta dhe antidiskriminim.²⁸ DHBGJ është përfshirë gjithashtu në Strategjinë për barazi gjinore 2021-2026.²⁹ Megjithatë, korniza kryesore e vendosur nga institucionet nacionale për të adresuar dhunën ndaj grave është PNV dhe Ligji i DHBGJ që ishte miratuar si pjesë e detyrimit të palës shtetërore për të zbatuar një ligj gjithëpërfshirës kundër DHBGJ të harmonizuar me dispozitat e Konventës të Stambollit.

²⁸ Ministria e punës dhe politikës sociale, *Plani strategjik i Ministrisë të punës dhe politikës sociale për vitet 2021-2023* [Plani strategjik i Ministrisë të punës dhe politikës sociale 2021-2023], Faqja zyrtare e internetit e Ministrisë së punës dhe politikës sociale, <https://www.mtsp.gov.mk/content/Strateski%20plan%20na%20MTSP%20za%202021-2023%20FINALEN%2014.01.2021.doc>

²⁹ *Стратегија за родова еднаквост 2021-2026* [Strategjia për barazi gjinore 2021-2026] (2021).



DHBGJ mbulon dhunën në familje, dhunën me bazë gjinore³⁰, dhunën nga partneri intim, dhunën fizike, dhunën psikologjike, ndjekjen, dhunën ekonomike, dhunën seksuale dhe përdhunimin, ngacmimin seksual, ngacmimin seksual onlajn, martesën e detyrueshme, gjymtimin gjenital femëror, abortin e detyrueshëm dhe sterilizimin e detyrueshëm, trafikimin e qënieve njerëzore/grave, dhe kontrollin e detyrueshëm mbi gratë si forma të dhunës ndaj grave. PNV në përgjithësi mbulon dhe përmend të gjithë format e DHBGJ. Në pjesën e parë, në lidhje me veprimin legjislativ strategjik dhe harmonizimin e ligjit nacional me Konventën e Stambollit – PNV shprehimisht përmend këto forma të DHBGJ: dhunë në familje, ndjekje, dhunë seksuale, martesë me fëmijë, gjymtimi gjenital femëror, krimet e nderit, dhe trafikimi me qenie njerëzore. Në pjesën e dytë, që i referohet shërbimeve të përgjithshme dhe speciale për viktimat, shprehimisht përmenden shërbimet për viktimat e dhunës seksuale dhe dhunës në familje. Përfundimisht, pjesa e tretë i referohet veprimeve që kanë të bëjnë me parandalimin e dhunës me bazë gjinore ku përmenden “të gjithë format e dhunës me bazë gjinore” dhe sidomos njeh dëshmitarët fëmijë të DHBGJ/si viktima.

Meqënëse këto politika në mënyrë specike synojnë dhunën me bazë gjinore dhe dhunën ndaj grave, kjo qasje bazohet te viktima, dmth., të drejtat e njeriut të viktimës janë të vendosura në qendër të politikave. Ligji për DHBGJ, si dhe PNV, krahas asaj që marrin parasysh një shkallë të gjërë të formave të DHBGJ, ata gjithashtu marrin parasysh aspektet e mundshme ndërseksionale të identiteteve të viktimave dhe propozojnë masa që synojnë kategoritë e rrezikuara të grave, siç janë gratë nga pakicat etnike, gratë shtatzëna, gratë që përdorin drogë, punëtorët seksi, azilkërkuessit, gratë migrante, gratë pa nënshitetësi, refugjatet, lezbiket, biseksuale dhe transgjinore, gratë që jetojnë me HIV, gratë pa strehim, etj.³¹

Megjithatë, sygjërimet sygjërojnë se përderisa në përgjithësi masat në PNV (që i referohen legjislacionit, sigurimit të shërbimeve dhe parandalimit të DHBGJ) marrin parasysh të drejtat e njeriut të viktimës, veprimet e caktuara kur zbatohen e ndjekin këtë qasje.³² Për shembull, një nga aktivitetet e parashikuara të PNV është përfshirja e viktimave të DHBGJ në programin e Ministrisë të shëndetësisë për mbrojtjen e nënave dhe fëmijëve, që do të thotë siguri i qasjes të lirë në shëndetësi për ata gra dhe fëmijë që nuk janë regjistruar si përdorues të sistemit për kujdes shëndetësorë. Programi ishte miratuar në vitin 2019 dhe merr në konsideratë vetëm gratë viktima të dhunës në familje por nuk parashikon qasje të lirë në shëndetësi për gratë viktima të formave tjera të DHBGJ.³³

³⁰ Është përkufizuar si dhunë ndaj grave sepse ndikon në mënyrë disproporcionale te grati më shumë se te burrat, dhe përfshin marrëdhëniet jo të barabarta të fuqisë ndërmjet burrave dhe grave që rrjedhin nga çështjet sociale/strukture dhe jo nga ata individuale.

³¹ Ministria e punës dhe politikës sociale, Акциски план за спроведување на Конвенцијата за спречување и борба против nasilstvoto врз жените и семејното nasilstvo на Република Македонија 2018-2023 [Plani i veprimit për zbatimin e Konventës për parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje në Republikën e Maqedonisë 2018-2023], <https://mtsp.gov.mk/content/word/oglasj/New%20node/Финал%20драфт%20НАП%20ИК%202018-2023.02.docx>; Закон за спречување и заштита од nasilstvo врз жените и семејното nasilstvo [Ligji për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna ndaj grave dhe dhuna në familje], *Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut*, No.24/2021.

³² Maja Balshikjeska dhe Ana Avramovska Nushkova, Извештај за напредокот на Р. Северна Македонија при спроведувањето на Националниот акциски план за имплементација на Истанбулската конвенција - октомври 2018 - октомври 2020 [Raporti i progresit mbi zbatimin e Planit nacional të veprimit për zbatimin e Konventës të Stambollit në Maqedoninë e Veriut - Tetor 2018 - Tetor 2020], (Rrjeti nacional për t'i dhënë fund dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, 2020), <http://www.glasprotivnasilstvo.org.mk/wp-content/uploads/2021/02/NAP-finalen.pdf>, 28.

³³ Ibid.



Për më tepër, programimi i përgjithshëm nga Ministria e punës dhe politikës sociale që duhet të përfshijë avancimin e pozitës ekonomike të grave viktimat të dhunës nuk është përqëndruar në viktimat e DHBGJ.³⁴ Rrjeti nacional për dhënien fund të DHNG dhe DHF ka realizuar një analizë të programimit të kësaj ministrie për periudhën 2015-2020 dhe ka përfunduar se gratë viktimat të dhunës me bazë gjinore nuk njihen si grupe specifike për masat e punësimit dhe masat tjera ekonomike që duhet të përshtaten me nevojat e viktimave.³⁵ Ngjajshëm, një shpallje e fundit (2021) për banesa sociale të publikuara nga Qeveria e Maqedonisë së Veriut³⁶, nuk përfshin shprehimishit viktimat e DHBGJ si candidate të përshtatshme për banesa sociale, ndërsa kategoritë siç janë fëmijët pa prindër, njerëzit që përdorin fonde minimale të mbrojtjes sociale, njerëzit e ndikuar nga katastrofat natyrore, njerëzit me aftësitë të kufizuara, romët dhe familjet me një prind janë kandidat të përshtatshëm.

Për të ofruar një reagim efektiv holistik dhe gjithëpërfshirës, duhet të koordinohen politikat në bazë të ligjit për DHBGJ dhe PNV. PNV parasheh masat specifike dhe veprimet që duhet të ndërmerren, institucioni përkatës për zbatimin e secilës prej masave specifike, treguesi sipas të cilit matet përparimi, korniza kohore e planifikuar për çdo veprim specifik, si dhe buxheti për çdo aktivitet. Megjithatë, linja e buxhetit të PNV vetëm ofron të dhënat për burimin e buxhetimit por jo edhe për shumën e ndarë për këtë veprim.

Me miratimin e PNV në tetor të vitit 2018, çdo ministri e linjës ishte obliguar që të përgatis planin operativ specifik (PO) për zbatimin e Planit të veprimit.³⁷ Për më tepër, këto plane operative duhet të ishin në dispozicion publik onlajn. Megjithatë, të dhënat sygjerojnë se jo vetëm se shumica e PO nuk janë në dispozicion publik, por shumë ministri të linjës nuk kanë përgatitur aspak planet e veprimit. Disa ministri kanë përgatitur PO vetëm për vitin 2019 por jo edhe për vitin 2020, dhe atë: Ministria e punës dhe politikës sociale, Ministria e punëve të brendshme, Ministria e shëndetësisë, Ministria e drejtësisë, Ministria e arsimit dhe shkencës dhe Ministria e shoqërisë informative dhe administratës. Për vitin 2020, vetëm 2 ministri (nga 16) kanë përgatitur planet operative, dhe këto janë Ministria e punëve të brendshme dhe Ministria e shëndetësisë.³⁸ Për vitin 2021, plani operativ ishte përgatitur nga Ministria e Drejtësisë.³⁹

Shumica e njësive të vetëqeverisjes lokale (80 komuna dhe Qyteti i Shkupit) të cilët bëjnë pjesë në jurisdiksionin e Ministrisë të vetëqeverisjes lokale nuk kanë përgatitur PO në pajtim me PNV. Vetëm gjashtë nga 80 komuna kanë përfshirë luftën ndaj DHBGJ si pjesë të synimeve të tyre strategjike.⁴⁰ Qyteti i Shkupit

³⁴ Ibid.

³⁵ Ibid.

³⁶ Qeveria e Maqedonisë së Veriut, "Оглас за распределба на 37 социјални станови во Струмица" [Shpallje për shpërndarjen e 37 banesave sociale në Strumicë], *Faqja zyrtare e internetit e Maqedonisë së Veriut*, <https://vlada.mk/node/25007>. Ju lutemi vëreni se, edhe pse kjo shpallje është konkretisht për Strumicën, monitoruesit tone kanë informata se ka të bëjë me disa komuna në Maqedoninë e Veriut.

³⁶ Rrjeti nacional për t'i dhënë fund të dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, *За прв пат во Западен Балкан се отвори куќа*

³⁷ Maja Balshikjeska dhe Ana Avramovska Nushkova, Извештај за напредокот на Р. Северна Македонија при спроведувањето на Националниот акциски план за имплементација на Истанбулската конвенција - октомври 2018 - октомври 2020 [Raporti i progresit për zbatimin e Planit të veprimit për zbatimin e Konventës të Stambollit në Maqedoninë e Veriut - Tetor 2018 - Tetor 2020], (Rrjeti nacional për t'i dhënë fund dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, 2020), <http://www.glasprotivnasilstvo.org.mk/wp-content/uploads/2021/02/NAP-finalen.pdf>.

³⁸ Po aty.

³⁹ Përgjigje në kërkesën për qasje në informat publike, dokumenti i arkivuar nr.19-1428/2021.

⁴⁰ Maja Balshikjeska dhe Ana Avramovska Nushkova, Извештај за напредокот на Р. Северна Македонија при спроведувањето на Националниот акциски план за имплементација на Истанбулската конвенција - октомври 2018 - октомври 2020 [Raporti i përparimit mbi zbatimin e Planit nacional të veprimit për zbatimin e Konventës të Stambollit në Maqedoninë e Veriut - Tetor



kishte përgatitur Strategjinë për barazinë gjinore në vitet 2021-2025 dhe një plan shoqërues veprimi, megjithatë që të dy dokumentet nuk janë publikisht të disponueshme.⁴¹ Në pajtim me Ligjin për mundësi të barabarta për gratë dhe burrat, njësitë e vetëqeverisjes lokale gjithashtu kanë detyrimin për të parashtruar raportet vjetore të progresit mbi statusin e mundësive të barabarta për gratë dhe burrat, duke përfshirë informatata mbi DHBGJ nëse të dhënat të tilla janë të disponueshme.⁴² Të dhënat e fundit tregojnë se 34 dhe në vendosjen e plotë të barazisë gjinore si fushë prioritare në punën e tyre dhe disfunkcionaliteti i mekanizmave shtetërore për [monitorimin] e statusit të barazisë gjinore në vend”.⁴³ Në mënyrë shtesë, sipas Neni 12 të Ligjit të DHBGJ, njësitë e vetëqeverisjes lokale duhet të përgatisin një protokoll për bashkëpunimin institucional dhe shumësektorial si bazë për të ndërmarrë veprime të përbashkëta për parandalimin dhe mbrojtjen ndaj DHBGJ. Nuk ka asnjë informacion të disponueshëm nëse është përgatitur një protokoll i tillë.⁴⁴

Sipas Nenit 15 të ligjit të DHBGJ, Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut është e detyruar që të formojë Trupin nacional koordinues për parandalimin dhe luftimin e dhunës me bazë gjinore me një mandat prej pesë vitesh. Ky trup ka tre anëtarë nga OSHC që punojnë me DHBGJ dhe DHF. Në mënyrë specifike, Neni 15(6) nga ligji i DHBGJ kërkon që Qeveria të publikojë një shpallje publike për anëtarët e trupit nga OSHC, dhe se anëtarët e zgjedhur do të jenë personat me të paktën pesë vite përvojë në DHBGJ dhe DHF⁴⁵ Përmes një kërkesë për qasje në informata publike, ne kemi marrë informatën se trupi i tillë ishte formuar me vendim të datës 8 qershor të vitit 2021. Vendimi i shpallur në Gazetën Zyrtare ka theksuar përbërjen e trupit sipas palëve të interesit, por nuk përfshin emrat e anëtarëve.⁴⁶ Në Ministria e punës dhe

2018 - Tetor 2020], (Korniza nacionale për dhënien fund të dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, 2020), <http://www.glasprotivnasilstvo.org.mk/wp-content/uploads/2021/02/NAP-finalen.pdf>.

⁴¹ Informacioni për miratimin e strategjisë është në faqen zyrtare të internetit të Qytetit të Shkupit, megjithë dokumentet aktuale të strategjisë dhe plani i veprimit nuk mund të gjendet në faqen e tyre të internetit (qasja e fundit në faqen e internetit është bërë në: 10.08.2021). Burimi: Qyteti i Shkupit, Град Скопје – Родово еднаков град [Qyteti i Shkupit – Qyteti i barazisë gjinore], Faqja zyrtare e internetit e Qytetit të Shkupit, (24.02.2021) https://skopje.gov.mk/mk/vesti/2019/24022021_nova_strategija_rodova_ednakvost/

⁴² Закон за еднакви можности на жените и мажите [Ligji për mundësi të barabarta të grave dhe burrave], *Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë*, Nr.6/2021; 30/2013; 166/2014; 150/2015; *Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut*, Nr.53/2021. Arts.14-15.

⁴³ Reaktor – Hulumtim në veprim. *Raporti në hije mbi zbatimin e Strategjisë për barazinë gjinore 2018/2019* (Reaktor – Hulumtim në veprim, 2020), <https://reactor.org.mk/en/publication-all/shadow-report-on-the-implementation-of-the-gender-equality-strategy-2018-2019/>, 32.

⁴⁴ Pas parashtrimit të kërkesës për qasje në informata publike, ne kemi pranuar një përgjigje në datë 05.07.2021 nga Ministria e vetëqeverisjes lokale të cilët kanë deklaruar se nuk janë kompetent për këtë çështje dhe na ka drejtuar në Ministrinë e punës dhe politikës sociale.

⁴⁵ Shpallja publike mund të gjendet në linkun e faqes të internetit të qeverisë për bashkëpunim me OSHC: <https://www.nvosorabotka.gov.mk/?q=mk/node/489>

⁴⁶ Trupi përbëhet prej: tre zyrtarëve të menaxhmentit nga Ministria e Punës dhe Politikës Sociale, anëtarë dhe zëvendës anëtar nga Ministria e Shëndetësisë, anëtarë dhe zëvendës-anëtarë nga Ministria e arsimit dhe shkencës, anëtarë dhe zëvendës anëtarë nga Ministria e shëndetësisë, anëtarë dhe zëvendës anëtarë nga Ministria e Arsimit dhe shkencës, anëtarë dhe zëvendës anëtarë nga ministria e Punëve të Brendshme, gjykatës dhe prokuror publik, përfaqësisë të njësive të vetëqeverisjes lokale, anëtarë të sindikatave, anëtarë të organizatave të punëtorëve, tre anëtarë të shoqërisë civile, një anëtar i Komisionit për mundësi të barabarta të grave dhe burrave dhe një anëtarë i klubit të deputeteve gra në kuadër të Parlamentit të Maqedonisë së Veriut. Burimi: Одлука за формирање на национално координативно тело за имплементација на Конвенцијата на Совет на Европа за спречување и борба против nasilstvo врз жените и семејно nasilstvo [Vendimi për formimin e trupit nacional koordinues për zbatimin e Konventës të Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftimin kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje], *Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut*, Nr.129/2021.



politikës sociale ne kemi pranuar⁴⁷ një dokument që është një vendim shtesë nga Qeveria, i datës 15.06.2021, që përmban një ndarje të detyruar të trupit.⁴⁸ Trupi ka mbajtur seancën e parë në 2 korrik të vitit 2021, me Ministrin e punës dhe politikës sociale si kryetare.⁴⁹ Në pajtim me ekspozenë nga kryetari-Ministri gjatë sesionit, trupi nacional koordinativ duhet të monitorojë zbatimin e Konventës të Stambollit, të rekomandojë masa për avancimin e barazisë gjinore dhe të luftojë dhunën ndaj grave, si dhe të rishikojë dhe marrë pjesë në përgatitjen e akteve nënligjore për dhunën ndaj grave në pajtim me Ligjin e ri, të cilat duhet të përgatiten.⁵⁰

Ministria e punës dhe politikës sociale ka pjesën më të madhe të veprimit në pajtim me PNV. Të dhënat e fundit në dispozicion tregojnë se shumica e aktiviteteve që bëjnë pjesë në përgjegjësitë e Ministrisë nuk janë realizuar por më krahasim me Ministrinë tjera të linjës ka realizuar më shumë aktivitete të konsideruara në numra absolut.⁵¹ Ministria me më pak aktivitete të realizuara është Ministria e Punëve të Brendshme sepse ka numrin më të vogël të aktiviteteve nën koordinim të saj (tre) dhe deri në këtë moment asnjë nuk është realizuar në tërësi. Megjithatë, është bërë pak përparim që nga tetori i vitit 2020 kur nuk kishte filluar asnjë aktivitet.⁵² Në kohën e shkrimit, nga tre aktivitetet të PNV, një aktivitet nuk ka filluar (amendamentet ndaj Ligjit për Policinë), një është realizuar pjesërisht (duke vendosur infratrakturën e “dhumave të rehatshme” për viktimat e dhunës dhe njerëzit me aftësi të kufizuara me qëllim që të shmanget viktimizimi i dyfishtë; dhomat e tilla janë vendosura në vetëm 8 stacione policore rreth shtetit) dhe një është i vazhdueshëm (publikimi i informatave onlajn mbi masat parandaluese kundër DHBGJ).⁵³

Në përgjithësi, institucioneve përgjegjëse për zbatimin e PNV u mungon transparencja. Pavarësisht detyrimit të tyre për të përfshirë shoqërinë civile në realizimin e aktiviteteve siç është përshkruar me PNV, ky në masë të madhe nuk ishte rasti në praktikë. Procesi i harmonizimit të dispozitave të Konventës të Stambollit me legjislacionin nacional është gjithashtu mungesa e transparencies. I tillë është rasti me Kodin penal ku përfaqësuesit e shoqërisë civile që punojnë me DHBGJ dhe DHF nuk marrin pjesë në grupin

⁴⁷ Ministria e punës dhe politikës sociale, përgjigje në pyetjen për qasje në informata të karakterit publik, dokument i arkivuar nr.14-4493/6 (27.07.2021).

⁴⁸ Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut, *Vendim për zgjedhjen e kryetarit, anëtarëve dhe zëvendës anëtarëve të Trupit nacional koordinues për zbatimin e Konventës të Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, 15 qershor i vitit 2021* [Vendim për emërimin e anëtarëve të presidentit, anëtarëve dhe zëvendës anëtarëve të Këshillit nacional koordinativ për Zbatimin e Konventës të Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, 15.06.2021], bashkangjitur në: Ministrinë e punës dhe politikës sociale, dokument i arkivuar nr.14-4493/6 (27.07.2021).

⁴⁹ Ministria e punës dhe politikës sociale, Министерката Шахпаска на првата седница на Националното координативно тело за спречување и борба против насилство врз жените и семејното насилство: Обезбедуваме нов и ефикасен пристап во справувањето со родово базираното насилство [Ministre Shahpaska në takimin e parë të Trupit nacional koordinues për zbatimin e Konventës të Këshillit të Evropës mbi parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje: Ne sigurojmë një qasje të re dhe efektive për trajtimin e dhunës me bazë gjinore], (02.07.2021), *Ministria e punës dhe politikës sociale*, https://mtsp.gov.mk/pocetna-ns_article-ministerkata-shahpaska-na-prvata-sednica-na-nacionalnoto-koordinativno-telo-za-sprecurvanje-i-borba-p.nspk

⁵⁰ По ату.

⁵¹ Maja Balshikjeska dhe Ana Avramovska Nushkova, Извештај за напредокот на Р. Северна Македонија при спроведувањето на Националниот акциски план за имплементација на Истанбулската конвенција - октомври 2018 - октомври 2020 [Raporti i progresit mbi zbatimin e Planit nacional të veprimit për zbatimin e Konventës të Stambollit në Maqedoninë e Veriut – Tetor 2018 – Tetor 2020], (Rrjeti nacional për t'i dhënë fund dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, 2020), <http://www.glasprotivnasilstvo.org.mk/wp-content/uploads/2021/02/NAP-finalen.pdf>.

⁵² По ату.

⁵³ Ministria e punëve të brendshme, përgjigje në pyetjen për qasje në informata publike, dokument i arkivuar nr. 16.12.910/1 (08.07.2021).

relevant të punës, dhe informatat mbi procesin nuk janë të disponueshme.⁵⁴ Përveç asaj, nuk ka informata publike për pothuajse të gjithë aktivitetet që zbatohen si pjesë e PNV. Madje edhe për themelimin e Trupit nacional koordinues, që ka tre anëtarë nga OSHC, informata nuk ishte e disponueshme onlajn.

Rekomandimet:

- Rishikoni PNV me qëllim që të pasqyrojë realitetin e zbatimit të tij me vonesë serioze.
- Të avancohet publikimi i informatave dhe të dhënave mbi zbatimin e PNV në fushën publike me qëllim të lehtësimit të monitorimit të pavarur të përparimit të zbatimit të tij.
- Zgjidhni kompetencën e njësive të vetëqeverisjes lokale dhe monitorini zbatimin e detyrimit të tyre për të publikuar planet operacionale.
- Prezantoni një zgjidhje sistemore të problemit të mungesës të aktorëve nga organizatat e shoqërisë civile në masat e ndërmarra në pajtim me zbatimin e Nenit 7 të Konventës të Stambollit.

Neni 9 – Organizatat joqeveritare dhe shoqëria civile

Shumë OSHC të grave në Maqedoninë e Veriut janë aktive në fushën e mbrojtjes dhe parandalimit të DHBGJ dhe DHF. Aktivitetet e tyre variojnë nga sigurimi i shërbimeve në monitorim dhe analizë. Shërbimet që ata ofrojnë janë të një shkalle të gjërë. Disa shembuj përfshijnë linjat ndihmëse SOS,⁵⁵ strehimoret,⁵⁶ këshillimi dhe shërbimet psikologjike,⁵⁷ ndihma juridike pa pagesë⁵⁸ dhe, në rastet e caktuara, përfaqësimin gjyqësorë për viktimat,⁵⁹ akomodim për viktimat që kanë braktisur mjedisin e dhunshëm⁶⁰ përballja me të qenit pa strehim. OSHC që punojnë me DHBGJ dhe DHF gjithashtu ishin aktive gjatë të gjithë krizës me KOVID -19, përveç se me sigurimin e ndihmës ligjore dhe ndihmës tjetër, gjithashtu duke bërë trysni te Qeveria për të përshtatur masat që ata po vendosnin dhe për t'i bërë ata të ndjeshme për viktimat dhe DHBGJ dhe DHF.⁶¹ Shumica prej këtyre OSHC kanë një ekspertizë shumë të fuqishme në fushë dhe ata njihen për këtë ekspertizë. Disa prej këtyre OSHC specializojnë në hulumtim dhe analizë dhe prodhojnë shembujt të rrallë

⁵⁴ Informacioni i bazuar në inputin e ofruar nga OSHC për Delegacionin e Bashkimit Evropian në Maqedoninë e Veriut, konsultimi për përgatitjen e dokumentit CLIP në kuadër të Planit gjinor të veprimit 3 të BE (në dosje me monitoruesit).

⁵⁵ Siç është Qendra e krizave Nadež's linjë ndihmëse SOS për konsulencë për kriza.

⁵⁶ Siç është akomodimi afatshkurtër (24 deri në 48 orë) strehimorja e krizës dhe dy strehimoret në territorin e Shkupit (të udhëhequra nga Organizata e OSHC e Grave të Shkupit dhe të financuar pjesërisht nga Ministria e punës dhe politikës sociale) dhe Strumica (e udhëhequr nga OSHC Sky Plus Strumicë dhe e financuar pjesërisht nga Komuna e Strumicës).

⁵⁷ Siç është Qendra e e parë familjare nga OSHC Hera dhe e financuar nga Qyteti i Shkupit.

⁵⁸ Siç është OSHC Komiteti i Helsinkit për të drejtat e njeriut.

⁵⁹ Siç është OSHC Shoqata e juristëve të rinj maqedonas .

⁶⁰ Siç është Rrjeti nacional për t'i dhënë fund dhunës në familje (akomodim deri në 6 muajs).

⁶¹ Rrjeti nacional për t'i dhënë fund dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, *Справување со насилство врз жените и семејно насилство во Западен Балкан за време и по здравствената криза со КОВИД-19* [Trajtimi i dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje në Ballkanin Perëndimor gjatë dhe pas krizës shëndetësore me KOVID -19] (Korrik 2020), <http://www.glasprotivnasilstvo.org.mk/wp-content/uploads/2020/09/Spravuvane-so-nasilstvo-vrz-zheni-i-semejno-nasilstvo-za-vreme-na-KOVID-19.pdf>.



të studimeve mbi DHBGJ dhe DHF që janë të disponueshme në Maqedoninë e Veriut.⁶² Përveç aktiviteteve të përmendura më sipër OSHC që punojnë me DHBGJ dhe DHG kanë gjithashtu kontribut në proceset e politikave publike si në nivel qendror (për shembull, hartimi i ligjit për DHBGJ dhe PNV) dhe niveli lokal (siç është përmes hartimit të strategjive për njësitë e vetëqeverisjes lokale për shembull Organizatat e grave në Shën Nikollë). Megjithatë, funksionimi i tyre është kontigjent në grantet e (projekteve) (nga donatorët ndërkombëtar multilateral dhe bilateral, siç janë BE, agjencitë e KB dhe në veçanti UN Women, Kvinna till Kvinna) që do të thotë se atyre u mugon financim i përgjithshëm dhe i qëndrueshëm në përgjithësi dhe financim gjithëpërfshirës dhe sistematik nga shteti konkretisht.⁶³

Përveç OSHC, gjithashtu ka rrjete të OSHC që punojnë në fushën e DHBGJ dhe DHF. Rrjeti nacional për dhënien fund të dhunës ndaj grave dhe dhunën në familje “Glas protiv nasilstvo”, me seli në kryeqytet – Shkup, bashkon 23 organizata⁶⁴ që mbulojnë shumicën e territorit të Maqedonisë së Veriut. Organizatat anëtare janë të madhësisë të ndryshme nga organizatat vogla qytetate në organizatat më të mëdha që funksionojnë në nivel nacional. Misioni i rrjetit për të arritur veprim të koordinuar të OSHC drejtë avancimit të politikave dhe praktikave në luftimin e DHNG dhe DHF.

Rrjeti bën përpjekje për të siguruar një qasje të unifikuar për shërbimet në të gjithë vendin, meqënëse në të tashmen qasja në shërbime në qytete të vogla është kufizuar krahasuar me qasjen në Shkup apo në qendrat më të mëdha rajonale (siç është Shtipi dhe Strumica).

Ligji për DHBGJ nje OSHC si partnerë në fushën e parandalimit dhe mbrojtjes ndaj DHBGJ. Veçanërisht, në nenin 24 sigurohen bazat ligjore që OSHC të ndërmarrin trajnimin e aktorëve shtetërorë, duke siguruar shërbime të specializuara, përgatitje të hulumtimeve dhe analizave në gjendjen e DHBGJ dhe DHF në shtet, të grumbullojë të dhëna dhe të bashkëpunojë me institucionet në fushën e DHBGJ dhe DHF. Përveç asaj, neni 12 thekson se njësitë e vetëqeverisjes lokale “bashkarisht me institucionet dhe asociacionet përgatisin Protokollin për bashkëpunim të ndërsjellë për masat për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna me bazë gjinore ndaj grave dhe dhunës në familje në komunitetin lokal”. Neni 15 parasheh themelimin e Trupit nacional koordinues për monitorimin dhe zbatimin e Konventës të Stambollit, dhe rezervon tre vende për anëtarët nga OSHC të cilët kanë të paktën pesë vite përvojë në DHBGJ dhe DHF. Disa protokolle që duhet të rregullojnë kontributin dhe angazhimin e OSHC, sidomos përmes sigurimit të shërbimeve, janë hartuar por ende nuk janë miratuar.⁶⁵ Përveç kësaj, OSHC që punojnë me DHBGJ dhe DHF duhet gjithashtu të respektojnë rregullat që zbatohen nga OSHC në Maqedoninë e Veriut në përgjithësi. Korniza kryesore për këtë është vendosur në Ligjin për shoqatat dhe fondacionet.⁶⁶

Megjithatë, deri vonë, nuk kishte një mbrojtje të formalizuar dhe koordinuar për mbrojtjen, parandalimin, ndjekjen dhe ndëshkimin ndërmjet OJQ-ve dhe aktorëve shtetërorë/të tjerë. Situata tashmë është e tillë ashtuqë bashkëpunimi ndërmjet OSCH dhe aktorëve shtetërorë është sporadik, i paqëndrueshëm dhe ndodh me iniciatëve të OSHC në vend se me aktorët shtetërorë. Për shembull, përfaqësuesit e OSHC kontribuojnë në punën e organeve të punës, organe lokale (siç janë këshillat për parandalim), etj.

⁶² Siç është Reakto – Hulumtim në Veprim.

⁶³ Instancat e financimit shtetëror (niveli qendror dhe lokal) janë vërejtur gjatë këtij rrapoti.

⁶⁴ Këtu më qaseni në listën e anëtarëve të këtij rrjeti: <https://www.glasprotivnasilstvo.org.mk/chlenovi-na-mrezhata/>

⁶⁵ Ministria e punës dhe politikës sociale, Përgjigje në pyetjen për qasje në informata publike, nr. i arkivës. 14-4493/6 (27.07.2021).

⁶⁶ Закон за здруженија и фондации [Ligji për shoqatat dhe fondacionet], *Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë*, Nr.52/2010; 135/2011; 55/2016.



Megjithatë, këto janë përjashtime, dhe jo një rregull dhe një rezultat i qasjes sistematike drejtë përfshirjes të OSHC. Kjo është konfirmuar më tutje në vëzhgimet më të fundit përfunduese në Maqedoninë e Veriut nga Komisioni i CEDAW, që ka lëshuar rekomandimin për “përforsimin e bashkëpunimit me organet e shoqërisë civile and palët tjera të përfshira me synimin e identifikimit dhe adresimit të situatave të përjashtimit, deprivimit, varfërisë dhe neglizhimit”⁶⁷ Ashtu siç raportuam në pjesën e Nenit 7, pavarësisht detyrimit të tyre për të përfshirë shoqërinë civile në zbatimin e aktiviteteve siç është përkrahur me PNV, ky në masë të madhe nuk ishte rasti në praktikë. Këtij procesi të harmonizimit të dispozitave të Konventës të Stambollit me legjislacionin nacional i mungon transparenca (për shembull, procesi i ndryshimit të Kodit penal), siç ishte procesi i themelimit të Trupit nacional koordinues, që ka tre anëtarë nga OSHC. Në bazë të kësaj, edhe pse janë bërë disa hapa fillestare, mund të përfundohet se nuk ka njohje përkatëse, mbështetje dhe inkurajim të punës të OSHC në luftimin e DHNG në të gjithë nivelet.

Rekomandimet:

- Prezantoni një zgjidhje sistematike për problemin e mungesës të përfshirjes të aktorëve nga organizatat e shoqërisë civile në masat e ndërmarra në pajtim me zbatimin e Nenit 7 të Konventës të Stambollit.
- Hartoni dhe miratoni të gjithë protokollet dhe rregullat e nevojshme për shfrytëzimin e tërësishëm dhe ekspertizën dhe potencialin për bashkëpunim efektiv, inkurajim dhe mbështetje të OSHC që punojnë me DHBGJ dhe DHF sa më shpejtë që është e mundur.

Neni 11 – Mbledhja e të dhënave dhe hulumtimi

Monitorimi i gjetjeve dhe hulumtimi i të dhënave dytësore zbulojnë se nuk është bërë shumë përparim në këtë drejtim pavarësisht përkushtimeve ligjore dhe politike. Ka disa entitete nacionale që grumbullojnë të dhëna relevante për llojet e ndryshme dhe thellësinë. Sidoqoftë, të dhënat e grumbulluara përmbajnë informacione mbi DHF dhe rastet penale që përfshijnë dhunën fizike dhe femicidin. Është shumë sfiduese për të gjetur të dhënat mbi lloje tjera të dhunës. Aktualisht nuk ka informacione të disponueshme për ndonjë mbështetje të koordinuar (sistematike) nacionale institucionale për hulumtim në fushën e të gjithë formave të dhunës të mbuluara me fushëveprimin e Konventës të Stambollit që do të lejojnë të studiohen shkaqet rrënjësore dhe efektet, incidencat dhe shkallët e ndëshkimit, si dhe efikasiteti i masave të ndërmarra që të zbatohet Konventa e Stambollit. Të dhënat nuk janë klasifikuar në pajtim me parametrat e nevojshme dhe të dhënat nga burimet e ndryshme janë shpesh të pakrahueshme në mënyrë të ndërsjellë. Ka raporte individuale nga institucionet zyrtare që ofrojnë një vështrim të pjesshëm...në...statistikat relevante administrative, por ata sfidohen që të krahasojnë dhe të analizojnë si të kombinuara (për shkak të mbledhjes të të dhënave të ndryshme të krijuara dhe/ose metodat e

⁶⁷ Komisioni mbi eliminimin e diskriminimit ndaj grave. *Vëzhgimet përfunduese në raportin e gjashtë periodik të ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë CEDAW/C/MKD/CO/6 (14.11.2018), para.12(e).*



kampinonimit, si dhe çështjet që lidhen me kontekstin e ndryshëm, siç është, për shembull, mungesa e raportimit apo vetëdijes në disa forma të dhunës. Rrjedhimisht, duket e sigurtë që të përfundojmë se, në përgjithësi, shtetit ende i mungon një përmbledhje sistematike të dhënave të ndara relevante statistikore në intervalet e rregullta të rasteve të të gjithë formave të dhunës të mbuluara nga Konventa e Stambollit. Komisioni i CEDAW ka shprehur shqetësim në lidhje me mungesën e përmbledhjes sistematike të të dhënave në rastet e DHBGJ dhe ndarjen sipas faktorëve relevant.⁶⁸

Shumë prej proceseve që duhet të kontribuojnë në sistematizimin dhe integrimin e përgjithshëm të proceseve të mbledhjes të të dhënave dhe të dhënat e mbledhura mbi DHBGJ, DHNG dhe DHF janë ende në vijim dhe është sfiduese të gjenden dhe konfirmohen informata zyrtare mbi statusin aktual të zbatimit të përkushtimeve të imponuara nga Konventa dhe/ose të dokumentet tjera relevante nacionale dhe strategjike dhe legjislativ të BE-së, duke përfshirë përkushtimet që lidhen me mbledhjen e të dhënave dhe hulumtimin. Ligji për DHBGJ përkufizon detyrimet e reja dhe të përmirësuara të entiteteve përgjegjëse për mbledhjen e të dhënave. Tabela Nr.1 më poshtë ofron një pasqyrë të entiteteve që kanë përgjegjësi për mbledhjen e të dhënave sipas këtij ligji.

Tabela Nr.1: Përgjegjësitë për mbledhjen e të dhënave sipas Ligjit për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna ndaj grave dhe dhuna në familje (2021) sipas institucionit, lloji i të dhënave të mbledhura dhe referencat e nenit

Institucioni	Të dhënat e mbledhura	Baza ligjore për detyrimin e mbledhjes të të dhënave, sa i përket ligjit për DHBGJ
Trupi nacional koordinues për monitorimin e zbatimit të Konventës të Stambollit The National Coordinative Body for Monitoring the Implementation of the Istanbul Convention	Koordinon dhe monitoron mbledhjen e të dhënave në dhunën me bazë gjinore kundër grave dhe dhunën në familje në pajtim me treguesit e parapërcaktuar	Neni 16, paragrafi 12
Ministria e punës dhe politikës sociale	Mbledh të dhëna mbi numrin e viktimave gra të dhunës me bazë gjinore dhe viktimat e dhunës në familje në sistemin e mbrojtjes sociale të ndarë sipas gjinisë, moshës, përkatësisë të bashkësisë, venbanimi, marrëdhënia ndërmjet viktimave dhe kryerësit, lloji dhe	Neni 17, paragrafi 8

⁶⁸ Mbi sfidat për mbledhjen e të dhënave në Maqedoninë e Veriut: Komisioni mbi eliminimin e diskriminimit ndaj grave, *Vëzhgimet përfunduese në raportin e gjashtë periodik të ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë CEDAW/C/MKD/CO/6* (14.11.2018), parag. 14(e), 16(e), 22(c), 24(e).



Institucioni	Të dhënat e mbledhura	Baza ligjore për detyrimin e mbledhjes të të dhënave, sa i përket ligjit për DHBGJ
	numri i shërbimeve të ofruara për viktimat dhe kryerësit dhe të dhënat tjera të përcaktuara me ligj nga institucionet në sistemin e mbrojtjes sociale dhe nga institucionet tjera kompetente për zbatimin e ligjit	
Ministria e punëve të brendshme	Mbledh të dhënat mbi numrin e rasteve të importuara të dhunës të me bazë gjinore ndaj grave dhe viktimat e dhunës në familje të ndarë sipas gjinisë, seksit, moshës, komitetit etnik, aftësisë të kufizuar, vendbanimit, marrëdhënies ndërmjet viktimës dhe kryerësit, kualifikimi i veprës penale dhe të dhëna tjera të përcaktuara me ligj	Neni 18, paragrafi 7
Ministria e shëndetësisë	Mbledh të dhëna mbi situatën e grave që janë viktimat të dhunës me bazë gjinore dhe viktimat e të dhënave në familje që kanë kërkuar ndihmë dhe intervenim përmes sistemit të kujdesit shëndetësorë të ndarë sipas gjinisë, seksit, moshës, komunitetit etnik, aftësisë të kufizuar, vendbanimit, viktimës dhe kryerësit, llojit dhe numrit të shërbimeve të ofruara për viktimat dhe të dhënat tjera në pajtim me Ligjin për të dhënat shëndetësore, si dhe për kryerësit	Neni 19, paragrafi 8
Shoqatat (dmth OSHC)	Realizoni një hulumtim dhe analizë mbi situatën me dhunën me bazë gjinore ndaj grave dhe dhunën në familje	Neni 24, paragrafi 3
	Mblidhni të dhëna mbi numrin e grave viktimat të dhunës me bazë gjinore dhe viktimat e dhunës në familje për të cilat ata kanë ofruar	Neni 24, paragrafi 4



Institucioni	Të dhënat e mbledhura	Baza ligjore për detyrimin e mbledhjes të të dhënave, sa i përket ligjit për DHBGJ
	ndihmë dhe mbështetje, të ndarë sipas gjinisë, seksit, moshës, përkatësisë etnike, aftësisë të kufizuar, vendbanimit, marrëdhënies ndërmjet viktimës dhe kryerësit, llojit dhe numrit të shërbimeve të ofruar për viktimat dhe kryerësit dhe të dhënat tjera të përcaktuara me ligj	
Sindikatat	Realizoni hulumtin dhe analizë mbi situatën me dhunën me bazë gjinore ndaj grave dhe dhunën në familje, raportoni rastet e dhunës me bazë gjinore ndaj grave, bashkëpunoni me shoqatat, fondacionet dhe organizatat tjera në promovimin dhe parandalimin e dhunës me bazë gjinore ndaj grave dhe dhunës në familje	Neni 25
Gjykatat	Krijoni dhe mbani të dhënat e veçanta mbi numrin e rasteve të dhunës me bazë gjinore ndaj grave dhe viktimave të dhunës në familje në bazë të gjinisë, seksit, moshës, përkatësisë etnike, aftësisë të kufizuar, vendbanimit dhe bazat tjera, si dhe të dhënat tjera relevante për monitorimin e situatës me dhunën e bazuar në gjini kundër grave dhe dhunës në familje, në pajtim me ligjin	Neni 29, paragrafi 1
Prokuroria Publike	Krijoni dhe mbani të regjistra special për rastet e dhunës me bazë gjinore kundër grave dhe viktimave të dhunës në familje në bazë të seksit, gjinisë, moshës, përkatësisë etnike, aftësisë të kufizuar, vendbanimit dhe bazave tjera, si dhe të dhëna që	Neni 30, paragrafi 1

Institucioni	Të dhënat e mbledhura	Baza ligjore për detyrimin e mbledhjes të të dhënave, sa i përket ligjit për DHBGJ
	janë relevante për monitorimin e situates me dhunën me bazë gjinore ndaj grave dhe dhuna në familje në pajtim me ligjin.	
Enti shtetëror për statistika	Realizoni një anketë nacionale për këtë situatë me dhunën me bazë gjinore kundër grave dhe dhuna në familje. Kjo anketë hulumtuese synon që të ofrojë informacion gjithëpërfshirës mbi numrin e rasteve të formave të caktuara të dhunës me bazë gjinore ndaj grave dhe dhunës në familje sipas gjinisë, seksit, moshës, etnicitetit, aftësisë të kufizuar, përkatësisë gjeografike të viktimës dhe kryerësit dhe informata tjera për monitorimin e situatës të dhunës ndaj grave	Neni 31, paragrafi 1 dhe 2

Megjithatë, përpjeket tona të monitorimit zbulojnë se Ministria e punës dhe politikës sociale, përmes qendrave lolake të punës, Ministria e punëve të brendshme (përmes raporteve të tyre policore), dhe gjykatat janë ndoshta entitetet e vetme zyrtare që mbledhin (një fushëveprim të caktuar të) të dhëna(ve) relevante.⁶⁹ Fakti se institucionet tjera të kontaktuar shpesh kanë ridrejtuar kërkesat tona dhe

⁶⁹ Një publikim i Lobit evropian të femrave në Maqedoninë e Veriut, të financuar nga BE dhe UN Women, që zbulon informata dytësore mbi fushat specifike dhe llojet e të dhënave për DHBGJ të mbledhura nga agjencitë për zbatimin e ligjit dhe qendrat sociale, gjithashtu nxit në këtë drejtim. Ky raport mbulon 3 segmente më të gjëra mbi dhunën e partnerëve intim, dhunën seksuale dhe dhunën kundër migrantëve dhe grave refugjate, dhe është e evidente se të dhënat, janë, edhe njëherë të mbledhura nga MPPS dhe MPB që janë përmendur më sipër. Ky raport thekson se:

- [dhuna nga partnerët intim] “Ministria e punëve të brendshme (MPB) mbledh dhe publikon të dhëna të ndara mbi DHF dhe MPPS mbledh rregullisht të dhëna mbi DHF. Të dhënat gjyqësore janë mbledhur, por ka mungesë të të dhënave mbi kryerësit e veprave penale të kryera në rrethana rënduese të dhunës në familje. Në statistikën zyrtare të personave të raportuar, akuzuar dhe të ndëshkuar, gjithashtu mungojnë të dhëna mbi viktimat. Femicidet (vrasjet e femrave) janë të padukshme në kuadër të statistikave nacionale, dhe aktualisht mbilidhen vetëm nga OSHC përmes raporteve mediatike. Disponueshmëria dhe transparenca e mbledhjes të të dhënave është një problem i vazhdueshëm.”

- [dhuna seksuale] “MPB mbledh të dhënat mbi dhunën seksuale vetëm për veprat penale dhe numrin e kryerësve që kanë kryer vepra penale dhe kanë të dhëna të kufizuara mbi të mbijetuarit. Rrjeti nacional i OSHC të grave ka mbledhur të dhëna mbi dhunën seksuale për periudhën prej vitit 2017 deri në vitin 2021 të mbledhura nga MPB dhe MPPS.”

- [Dhuna ndaj migrantëve dhe grave refugjate] Ka mungesë të të dhënave në këtë segment për shkak të natyrës specifike dhe sfiduese të migrimit, të elaboruar në raport. Ka një referencë të mëtutjeshme në studimin e UN Women mbi krizën e refugjatëve dhe mirgrimit në Serbi dhe Maqedoninë e Veriut, që merret me sfidat e ndërlydhura në nivelin e përgjithshëm rajonal dhe nuk informon në mënyrë specifike për ndonjë praktikë për mbledhjen e të dhënave.



drejtoheshin drejtë institucioneve tona e dëshmon këtë. Për ilustrim të mëtutjeshëm, faja e internetit e Entit shtetëror për statistika përmend anketën e DHBGJ dhe DHF, si pjesë të aktiviteteve të tyre të financuara të IPA II për periudhën 2019-2021. Megjithatë, asnjë nga palët e konsultuara nuk mund të ofrojnë informacion të mëtutjeshëm për këtë. Përgjigja zyrtare nga Enti shtetëror për statistika më tutje ka konfirmuar se nuk ka të dhëna të tilla të mbledhura nga ky institucion deri tani.⁷⁰ Informacionet statistikore që janë publikisht të disponueshme në uebfaqen e tyre janë mjaftë të kufizuara dhe nuk janë mjaftueshëm të detajuara për të nxjerrur ndonjë përfundim mbi rastet e DHBGJ dhe DHNG apo apo për të studiuar shkaqet rrënjësore dhe efektet, incidentat dhe shkallët e ndëshkimit, si dhe efikasitetin e masave për të zbatuar Konventën e Stambollit (për shembull, raportet zyrtare statistikore përmbajnë informata mbi vdekjet e dhunshme nga shkaqet e jashtme të vdekjes, moshë dhe gjinia, megjithatë, nuk ka informacion mbi gjininë e kryerësit⁷¹).

Përveç asaj, në pajtim me Nenin 11 të ligjit për DHBGJ, “të gjithë organet e administratës shtetërore, gjykatat, prokurorët publik, njësitë e vetëqeverisjes lokale dhe personat juridik që ushtrojnë kompetenca publike të përcaktuara me ligj” janë të obliguar që të mbledhin të dhëna statistikore dhe administrative për situatën me DHBGJ, DHNG, dhe DHF në bazë të gjinisë, seksit, moshës, përkatësisë etnike, vendbanimit dhe të dhëna tjera të përcaktuara me këtë apo me ligj tjetër, dhe në pajtim me dispozitat e Ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale. (Neni, paragrafi 1). Ligji për DHBGJ më tutje i referohet platformës nacionale për interoperabilitet – Agjencia informative maqedonase (AIM) që ka ekzistuar tashmë para miratimit të ligjit për DHBGJ. MIM është parashikuar si platformë për shkëmbimin e drejtëpërdrejtë të të dhënave, që do të përdoret çdo ditë nga MPPS (Neni 28, paragrafi 2) dhe 3)). Sidoqoftë, në mungesë të një protokollit të vendosur, mbledhja e të dhënave dhe shkëmbimi i të dhënave mund të vlerësohen, në rastin më të mirë, si të diskutueshme.

Në pajtim me Konventën, anketat e bazuara në popullsi duhet të mbështeten në nivel nacional dhe të ndodhin në intervale të rregullta, dhe deri më sot, ky nuk është rasti me Maqedoninë e Veriut. Megjithatë, anketat e bazuara në popullsi për të vlerësuar mbizotërimin dhe tendencat në të gjithë format e dhunës të mbuluara me fushëprimin e Konventës, dhe hulumtimin tjetër të rëndësishëm në këtë fushë, ende realizohen nga organizatat e grave (apo kompanitë private hulumtuese) përmes fondeve të donatorëve të huaj. Rrjedhimisht, nuk mund të konsiderohet se pala shtetërore ka përmbushur obligimin e saj sipas Nenit 11(2). Anketa e vetme e fundit statistikore përfaqësuese në nivel shtetëror mbi dhunën ndaj grave ishte anketa e udhëhequr nga OSBE “Siguria dhe mirëqënia e grave” e realizuar në vitin 2018 dhe e publikuar në vitin 2019.⁷²

Burimi: Biljana Nastovska, *Hartëzimi i politikave dhe legjislacioni mbi dhunën ndaj grave dhe Konventën e Stambollit në IRJ të Maqedonisë (Lobi I grave, 2018)*, https://www.womenlobby.org/IMG/pdf/ewl-fyr_macedonia_report_web.pdf, 5.

⁷⁰ Përgjigja që ne kemi pranuar ishte një “Jo” e shkurtër pa ndonjë detaj për planet e mundshme të ardhshme për mbledhjen e të dhënave për DHBGJ dhe DHF. Konsultimet shitesë me përfaqësuesit e Entit shtetëror për statistika konfirmojnë se kjo anketa ishte planifikuar dhe shtyrë dy herë për shkak të çështjeve urgjente që lidhen me regjistrimin nacional dhe pandeminë e Covid-19.

⁷¹ Enti shtetëror për statistika, *Njoftim për shtyp: Popullsia – Vdekjet e dhunshme në Republikën e Maqedonisë së Veriut në Maqedoninë e Veriut, 2018*; e disponueshme në: https://www.stat.gov.mk/pdf/2019/2.1.19.24_mk.pdf

⁷² Rezultatet e plota janë bërë publike në uebfaqen e OSBE. Kjo është anketa e parë përfaqësuese e realizuar në Evropën Juglindore dhe në Evropën Lindore për të ofruar të dhëna krahasuese në rajon (dhe me anketën ADTH të realizuar në BE në

Përveç asaj, vëllimi i parë i Indeksit për barazinë gjinore për Maqedoninë e Veriut⁷³ mbetet i zbrazët kur bëhet fjalë për DHBGJ dhe DHNG meqenëse nuk ka të dhëna zyrtare mbi mbizotërimin nacional të rasteve, seriozitetin, dhe raportimin për periudhën të cilës i referohet ky Indeks (dmth vitit 2015). Ka hapësirë për përmirësim në këtë drejtim dhe vëllimi i ri i Barazisë gjinore do inkorporojë informata mbi DHBGJ /DHNG të udhëhequr nga OSBE dhe studimi me bazë në ADTH mbi mirëqënien dhe sigurinë e grave⁷⁴. Vazhdimësia e indeksit të barazisë gjinore do të përgatiten gjatë vitit 2021. Thirrja për ekspertët për mbledhjen e të dhënave dhe për hartimin e indeksit ishin publikuar në kohën e shkrimit të këtij raporti.⁷⁵

Avokati i popullit duhet gjithashtu të grumbullojë të dhëna mbi DHBGJ dhe DHNG, siç është përmendur në Planin vjetor operacional të Ministrisë të drejtësisë. Sidoqoftë, hulumtimet dhe intervistat e kaluara⁷⁶ zbulojnë se fokusi kryesor është mbi të drejtat e fëmijëve dhe të dënuarve (duke përfshirë të dënuarat që janë gra). Raporti i tyre vjetor nuk zbulon asnjë hollësi mbi numrin e rasteve dhe llojeve të dhunës dmth vetëm adreson në mënyrë cilësore çështjet kryesore, gratë, burrat, dhe fëmijët përballen përmes analizës të rasteve individuale dhe ankesave që pranon Avokati i popullit gjatë vitit. Raporti i fundit që është publikisht i disponueshëm është nga vitit 2019.⁷⁷ Kur flasim për DHBGJ dhe DHNG, duhet të theksohet se Avokati i popullit kryesisht elaboron ankesat për mbrojtjen ndaj DHF të dorëzuara kryesisht nga grate viktime, me fokus të veçantë të fëmijët si viktime jo të drejtëpërdrejta. Avokati i popullit gjithashtu thekson mosfunksionimin praktik të Trupit nacional koordinues kundër dhunës ndaj grave të themeluar para disa viteve sipas ligjit për DHF të vitit 2014.⁷⁸

vitin 2014) dhe përfshin sjelljet dhe përvojat gjinore të grave nga grupet e pakicave. Synon që të themelojë një studim themelor dhe të ofrojë të dhëna shumë të rëndësishme me qëllim të zhvillimit të politikave, strategjive, programeve dhe aktiviteteve më gjithëpërfshirëse dhe të bazuara në dëshmi për të parandaluar dhe luftuar DHNG. Ajo mbulon të gjithë format e dhunës përmes moduleve të ndryshme (duke përfshirë përvojat që lidhen me konflikt) dhe eksploron përvojat e dhunës ndërmjet një kampioni përfaqësues në të gjithë shtetit të 1,910 grave të moshës 18–74, duke përfshirë 496 gra të përkatësisë etnike shqiptare. Ajo ishte bazuar në një dizajn kampionimi me shumë nivele, të shtresuar të probabilitetit të rastit. Linku për studimin e përfunduar: OSBE, Mirëqënia dhe siguria e grave – Maqedoni e Veriut (OSBE, 2019), https://www.osce.org/files/f/documents/3/5/419264_1.pdf

⁷³ Marija Bashevka, *Индекс на родова еднаквост* [Indeksi i barazisë gjinore] (Ministria e punës dhe politikës sociale, Instituti evropian mbi barazinë gjinore, Enti shtetëror për statistika dhe UN Women, 2019), http://www.mtsp.gov.mk/content/pdf/dokumenti/2019/Gender%20Index_MK_01.pdf.

⁷⁴ OSBE, Mirëqënia dhe siguria e grave – Maqedonia e Veriut (OSBE, 2019), https://www.osce.org/files/f/documents/3/5/419264_1.pdf.

⁷⁵ Duhet të theksohet se, megjithatë thirrja ishte hapur vetëm për tre ditë punë të ndara me një fundjave dhe festë shtetërore. Thirrja është e disponueshme këtu:

<https://www.mtsp.gov.mk/content/pdf/2021/огласи%20марија/оглас%20за%20ангажирање%20на%20експерт%20за%20прибирање%20и%20обработка%20на%20податоци%20за%20Националниот%20индекс%20на%20р.е.во%20С.М.%20за%202021..PDF>.

⁷⁶ Analiza e të dhënave dytësore për qëllimin e vendosjes të kontekstit për studimin e udhëhequr nga OSBE mbi Mirëqënien dhe sigurinë e grave kanë përfshirë një intervistë të ekspertit kryesor me zëvendësin e Avokatit të popullit ku ajo në mënyrë të qartë thekson se ato merren me rastet me fëmijët dhe të dënuarit dhe se nuk kanë patur një pikë të fokusit gjinor që do të merrej në mënyrë specifike me këtë lloj të rasteve dhe informatave. Gjithashtu ishte shpallur që Avokati i popullit planifikon të realizojë një vizitë studimore dhe të mbledh të dhëna nga ofruesit e të dhënave administrative por ende nuk ka informata të disponueshme deri sot nëse ky system është kompletuar. Burim: Personi monitorues dorëzon këtë informacion ishte një studiues kryesor i lartë për këtë studim për Maqedoninë e Veriut dhe Kosovën. Të dhënat e përfshira janë nga intervista e ekspertit kryesor të realizuar në qershor të vitit 2016, që është përmendur shkurtimisht në udhëtimin e përmendur më sipër të udhëhequr nga OSBE.

⁷⁷ Avokati i popullit, Raporti vjetor mbi shkallën e sigurimit, respektimit, avancimit dhe mbrojtjes të të drejtave dhe lirive të njeriut 2019 (2020), <http://ombudsman.mk/upload/Godisni%20izvestai/GI-2019/GI-2019-Ang.pdf>

⁷⁸ Ibid, 22.



Sipas planit vjetor operacional të Ministrisë të drejtësisë⁷⁹ për zbatimin e PNV të dytë për zbatimin e Rezolutës të KB 'Gratë, paqja dhe siguria' (2020-2025), për vitin 2021, janë marrë parasysh dy studime të ndryshme të hulumtimit në lidhje me DHBGJ/DHNG: (1) Hulumtimi i Avokatit të popullit mbi DHF dhe DHNG– analiza e të dhënave që përfshijnë rastet e raportuara të DHNG, dhe (2) analiza që janë pjesë e raportit vjetor për zbatimin e Ligjit për ndihmën juridike falas të vitit 2020. Nuk ka informata që janë publikisht të disponueshme nëse aktivitetet e përmendura të studimit kanë filluar dhe raporti i fundit i publikuar në uebfaqen e ministrisë i referohet vitit 2029. Për më tepër, Plani i tyre operacional për zbatimin e Planit të veprimit për zbatimin e Konventës të Stambollit 2018-2023⁸⁰ nuk përfshin aktivitete të planifikuara në lidhje me studimin dhe mbledhjen e të dhënave. Asnjë nga planet operative të kësaj ministrie nuk ofron detaje të mjaftueshme për të nxjerrur ndonjë përfundim të mëtutjeshëm dhe atyre u mungojnë informata thelbësore mbi buxhetimin, dmth. Nuk ka alokime të caktuara të buxhetit, vetëm referenca të paqarta për burimet e buxhetit publik. Kur flasim për buxhetimin, shumica e entiteve përgjegjëse kanë sjellje të ngjajshme në dokumentet e tyre të raportimit dhe planifikimit.⁸¹

Organizatave të shoqërisë civile (OSHC) mund të veprojnë si një burim i rëndësishëm për informim mbi rastet e DHBGJ dhe DHNG dhe të mbizotërojnë përmes të dhënave të tyre për shërbimet e ofruara (në rast të sigurimit të shërbimeve për viktimat e DHBGJ dhe DHNG). Për shembull, raporti i pestë i "Të drejtave të grave në Ballkanin Perëndimor" i publikuar nga Fondacioni Kvinna till Kvinna, që monitoron situatën me të drejtat e grave në gjashtë shtetet në rajon, përfundon se nuk ka të dhëna të mjaftueshme mbi rastet e sanksionuara në shtetet e Ballkanit Perëndimor dhe se femicidet nuk janë të njohura si formë e veçantë vrasjes. Në pothuajse të gjithë shtetet e mbuluara nga ky raport, OSHC-të e grave janë personat e vetëm juridik që grumbullojnë të dhëna mbi homicidin si rezultat i dhunës me bazë gjinore.⁸² Tabela Nr.2 më poshtë jep një pasqyrë të shkurtër të disa prej OSCH-ve kryesore dhe aktive që mbledhin segmente të ndryshme të të dhënave mbi DHBGJ dhe DHNG.

Tabela Nr.2: OSHC që mbledhin të dhëna mbi DHBGJ dhe DHNG

⁷⁹ Ministria e drejtësisë, Годишен оперативен план на Министерството за правда за 2021 година [Plani vjetor operativ i Ministrisë të drejtësisë për vitin 2021] (Ministria e drejtësisë, 2021) <https://www.pravda.gov.mk/Upload/Documents/MP%20Operativen%20Plan%20za%202021%20%20R%2013%2025%20R.PDF>

⁸⁰ Ministria e drejtësisë, Оперативен план за 2021 година за спроведување на Акцискиот план за спроведување на Конвенцијата за спречување и борба против nasilството врз жените и семејното nasilство на Република Македонија 2018-2023 [Plani Operativ për vitin 2021 për zbatimin e Planit të veprimit për zbatimin e Konventës për parandalimin dhe luftën e kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje në Republikën e Maqedonisë 2018-2023] (Ministria e drejtësisë, 2021) <https://www.pravda.gov.mk/Upload/Documents/%D0%9D%D0%90%D0%9F%20%D0%93%D0%A0%D0%95%D0%92%D0%98%D0%9E%202021.PDF>

⁸¹ Nga koha e mbylljes të raportit në hije, në nuk kemi pranuar përgjigje në pyetjet për qasje në informata publike për të elaboruar/refuzuar më tutje disa prej pikëve.

⁸² Kvinna till Kvinna, *Të drejtat e grave në Ballkanin Perëndimor* (2021), http://www.glasprotivnasilstvo.org.mk/wp-content/uploads/2020/11/WRWB_2020.pdf



OSHC/Rrjeti i OSHC	Të dhënat e mbledhura
Dhënen fund të dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje	Raportet vjetore të femicidit, gjithashtu përfshijnë raportet e mediave të vitit 2020 ⁸³ dhe publikimet tjera dhe studimet ad hoc, si për shembull Studimi i tyre për fushëveprimin e formave të ndryshme të dhunës seksuale ⁸⁴
Shoqata ESE	Raportet vjetore mbi shpenzimet dhe cilësinë e qasjes në drejtësi për gratë që kanë vuajtur dhunën në familje ⁸⁵
Reaktor – Hulumentim në veprim	Studimet e fushëveprimit që vlerësojnë trendet dhe ndryshimet në manifestimin e dhunës dhe perceptimet e sigurisë në hapësirën publike në emër të vajzave dhe grave ⁸⁶
HERA	Raportet vjetore ofrojnë disa informata të përgjithshme mbi DHBGJ dhe DHF dhe ata mund të përdoren si burime të informatave mbi grupet e rrezikuara. Për shembull, raporti i tyre i fundit informon se vajzat dhe gratë me aftësi të kufizuara të cilat kanë më shumë gjasa që të përjetojnë dhunë të bazuar në gjini dhe të vuajnë një periudhë më të gjatë kohore, duke u bazuar në studimin e realizuar në objektin publik Banjat e Banskos ⁸⁷
Komisioni i Helsinkit për të drejtat e njeriut	Disa informata mund të merren përmes raporteve dhe analizave të tyre të ndryshme në lidhje me rastet e ndihmës juridike, në veçanti mbi diskriminimin (duke përfshirë diskriminimin interseksional)
Këshilli nacional për barazi gjinore (SOZM)	Një studim mbi DHF, me titull: Raporti përfundimtar: informimmi dhe mbledhja e të dhënave nga viktimat e

⁸³ Rrjeti nacional për t'i dhënë fund dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, *Анализа на случаи на фемидиди – убиства на жени во Република Македонија* [Analiza e rasteve të femicidit (vrasjes të grave) – vrasja e grave në Republikën e Maqedonisë] (2018), <http://www.glasprotivnasilstvo.org.mk/wp-content/uploads/2013/11/Femicidi-mk.final.pdf>.

⁸⁴ Rrjeti nacional për t'i dhënë fund dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, *Студија на опсег на различните форми на сексуално насилство во Р.Македонија* [Studimi i fushëveprimit të formave të ndryshme të dhunës seksuale në R. Të Maqedonisë] (2017), <http://www.glasprotivnasilstvo.org.mk/wp-content/uploads/2013/11/studija-za-seksualno-nasilstvo-vo-rm-1.pdf>

⁸⁵ Shoqata për emancipimin, solidaritetin dhe barazinë e grave, *Shpenzimet dhe cilësia e qasjes në drejtësi për grate që kanë përjetuar dhunën në familje, 2020* (2020), <http://esem.org.mk/pdf/Publikacii/2020/Cost%20and%20benefit%20analysis%20domestic%20violence%202020.pdf>.

⁸⁶ Reaktor – Hulumentim në veprim, *Dhuna me bazë gjinore në hapësirat publike në Shkup* (Reaktor – Hulumentim në veprim, 2020), <https://reaktor.org.mk/en/publication-all/gender-based-violence-in-public-spaces-in-skopje/>.

⁸⁷ HERA, *2020 Raporti vjetor – Mbështetja e të rrezikuara në kohë të krizës, Mbrojtja e të drejtave sociale dhe riprodhuese!* (HERA, 2020), https://hera.org.mk/wp-content/uploads/2021/06/Godishen-izveshtaj-za-2020-godina_en-web.pdf, 21.



OSHC/Rrjeti i OSHC	Të dhënat e mbledhura
	dhunës me bazë gjinore dhe monitorimi dhe rekomandimi për avancimin e politikave lokale për mbështetje dhe mbrojtje të viktimave të dhunës me bazë gjinore ⁸⁸
HOPS	Të dhënat mbi DHBGJ kundër grave që përdorin drogë. ⁸⁹
Koalicioni Margjini	Dokumenton rastet e dhunës në lidhje me të drejtat seksuale dhe shëndetësore të komuniteteve të marginalizuara (duke përfshirë lezbiket, punëtorët e seksit që janë gra dhe trans gratë); ⁹⁰ dhuna seksuale dhe në familje ndaj fëmijëve. ⁹¹

Ka shoqata tjera të rëndësishme dhe OSHC që mbledhin segmente të ndryshme të të dhënave për DHBGJ/DHNG qoftë në bazë të rregullt (kryesisht ofruesit e shërbimeve të OSHC) apo përmes anketave ad hoc që adresojnë forma specifike të dhunës. Burimet e ekspertëve theksojnë një numër të vogël të OSHC me fokus më të ngushtë si shembuj të ndritur në fushën e mbledhjes të të dhënave mbi DHF dhe DHBGJ dhe luftimin e këtyre çështjeve. Ata përfshijnë organizata si: EHO Stip dhe organizata e tyre partnere që ka bërë një analizë në lidhje me viktimat e DHF dhe mbështetjen ligjore pa pagesë për qytetet e Shtipit dhe Strumicës, pastaj strehimorja lokale dhe qendrat e këshillimit, që janë pjesë e organizatave civile siç janë HERA, HOPS, NGO Antiko, Shoqata e grave të Shën Nikollës, dhe të tjerë. Sidoqoftë, nevojiten eksplorime të mëtutjeshme për të ofruar informacion më specifik dhe të informuar mbi gjendjen e përgjithshme të çështjeve, për shkak të mungesës të informatave të përditësuara në uebfaqet e tyre përkatëse dhe kanalet digjitale të informimit dhe fakti se ka një trup të madh shumë të fragmentuar të raporteve të ndryshme që kërkon krahasime të mëtutjeshme, konsolidim dhe verifikim të gjetjeve, me qëllim që të sigurohen informata gjithëpërfshirëse dhe të besueshme.⁹²

Sa i përket llojit të të dhënave dhe nëse/si janë të ndara (sipas seksit, moshës, llojit të dhunës si dhe marrëdhënies të kryerësit me viktimën, lokacionin gjeografik, dhe faktorët tjerë që konsiderohen të rëndësishëm, për shembull, aftësia e kufizuar), gjatë periudhës të monitorimit, entitetet e kontaktuar nuk kanë ofruar informacion të mjaftueshëm për të konfirmuar nëse të dhënat janë të ndara në mënyrën e

⁸⁸ SOŽM, *Raporti përfundimtar: Informimi dhe mbledhja e të dhënave nga viktimat e dhunës me bazë gjinore dhe rekomandimi për avancimin e politikave lokale për mbështetjen dhe mbrojtjen e viktimave të dhunës me bazë gjinore* (2014), http://www.sozm.org.mk/index.php?option=com_content&view=article&id=196%3A2014-12-03-13-34-03&catid=16%3A2013-03-12-20-31-54&Itemid=43&lang=en.

⁸⁹ HOPS, *Родово базирано насилство врз жените кои употребуваат дроги* [Dhuna me bazë gjinore kundër grave që përdorin drogë] (HOPS, 2021), <https://hops.org.mk/wp-content/uploads/2021/06/hops-5.pdf>.

⁹⁰ Të dhënat që i përmban raporti vjetor i Koalicionit Margjini, i disponueshëm në: <http://coalition.org.mk/publikacii/izvestai>

⁹¹ Lina Kjostarova Unkovska, *Имаме ли победник? Родови нееднаквости во здравјето и животните перспективи на адолесцентите од Северна Македонија* [A kemi fitues në lidhje me perspektivën e shëndetit dhe jetës të adoleshentëve në Maqedoninë e Veriut], (Koalicioni Margjini, 2020), http://coalition.org.mk/wp-content/uploads/2020/10/margini_rodovi-neednakvosti_2020_final.pdf

⁹² Përveç kufizimeve metodologjike, të vërejtura në hyrjen e këtij raporti, pandemia e përgjithshme Kovid -19 ka ndikuar ndoshta në mungesën e informatave të përditësuara jo vetëm në rastin e OSHC por gjithashtu edhe në rastin e institucioneve të përmendura.



duhur dhe nëse ndonjë sfidë e mëparshme në mbledhjen e të dhënave është adresuar nga institucionet (për shembull, duke u bazuar në gjetjet e mëparshme, të dhënat policore nuk kanë përfshirë marrëdhënien ndërmjet viktimës dhe kryerësit, megjithatë përgjigjen që ne kemi pranuar nga Ministria relevante, që ka përmbajtur një link të përgjithshëm për faqen e tyre të internetit ishin raporte për të dhënat aktuale dhe për lidhjen e burimeve, nuk ofrojnë informacione të mjaftueshme për të përfunduar se kjo ishte zgjedhur).

Burimet e konsultuara që janë publikisht të disponueshme dhe informacioni i mëparshëm thekson se ka mungesë të konsiderueshme të të dhënave të publikuara dhe të ndara në nivele të ndryshme, dhe kur flasim për pabarazi të shumëfishta dhe ndërseksionale dhe grupe të marginalizuara, të dhënat zyrtare pothuajse nuk ekzistojnë. Për të ilustruar rëndësinë e situatës me të dhënat mbi DHBGJ/DHNG, ne mund të marrin uebfaqen e MPPS si një shembull. Kjo ministri duhet të raportojë rregullisht situatën për DHBGJ/DHNG apo dhunën në familje përmes raporteve të tyre javore që përmbledhin informatat për qendrat sociale për rastet e raportuara në vend. Megjithatë, informacioni i publikuar është i ndërprerë dhe i vjetëruar dhe nuk është në pajtim me kërkesat ligjore dhe përkushtimet e imponuara me Ligjin e ri apo PNV mbi zbatimin e Konventës të Stambollit – burimi në faqen e tyre elektronike i është dedikuar raportimit javor mbi dhunën në familje që përmban vetëm raporte dy javore nga maji dhe qershori i vitit 2020.⁹³

Informacioni i disponueshëm dhe burimet e konsultuara të ekspertëve theksojnë se ka shumë hapësirë për përmirësime, të cilat duhet të priten pasi që të bëhet zbatimi i ligjit të ri. Vendosja e mekanizmit për të monitoruar zbatimin e e PNV (dmth vendosjen e trupit nacional koordinues) është thelbësor për përmirësimin e sistemit për mbledhjen e të dhënave mbi DHBGJ dhe DHNG dhe cilësia e të dhënave të mbledhura.

Informacioni mbi mbledhjen dhe publikimin e të dhënave në nivel nacional nuk është përfundimtar në rastin më të mirë. Raporti i fundit në hije për përparimin e R. e Maqedonisë së Veriut në zbatimin e Planit nacional të veprimit për zbatimin e Konventës të Stambollit, është lëshuar nga Rrjeti nacional për t'i dhënë fund dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje⁹⁴ nuk zbulon ndonjë informatë mbi mbledhjen e të dhënave dhe llojin e të dhënave të mbledhura nga entitetet relevante. E njëjta vlen edhe për Indeksin e barazisë gjinore, që përjashton DHBGJ/DHNG për shkak të mungesës të të dhënave publike dhe që janë publikisht të disponueshme. Kjo është kryesisht sepse ende nuk ka një sistem uniform për mbledhjen e të dhënave dhe të gjithë proceset që rregullojnë dhe përkufizojnë atë janë ende në vijim.

Plani nacional i veprimit për zbatimin e Konventës të Stambollit parasheh krijimin e metodologjisë për mbledhjen e unifikuar dhe përpunimin e të dhënave nga institucionet dhe organizatat që ofrojnë mbështetje të drejtëpërdrejtë për viktimat e të gjithë formave të dhunës. Në fushën e aktiviteteve dhe veprimeve parandaluese, gjithashtu parasheh rritjen e rolit të Avokatit të popullit në monitorimin e femicidit – vrasjes të grave, dmth vendosjen e një mekanizmi për mbikëqyrjen e femicidit. Megjithatë, trupi

⁹³ Faqja e internetit të MPPS ka një faqe të dedikuar për raportimin e dhunës në familje: https://mtsp.gov.mk/ns_article-prijavi-semejno-nasilstvo.nspox (Ipër herë të fundit është qasur në 7 dhe 28 qershor dhe në 15 korrik të vitit 2021). Në kohën e mbylljes të këtij raporti, ne kemi pranuar informata nga MPPS për informacionin shtesë të kërkuar.

⁹⁴ Maja Balshikjeska dhe Ana Avramovska Nushkova, *Извештај за напредокот на Р. Северна Македонија при спроведувањето на Националниот акциски план за имплементација на Истанбулската конвенција - октомври 2018 - октомври 2020* [Raporti i progresit të Planit nacional të veprimit për zbatimin e Konventës të Stambollit në Maqedoninë e Veriut - Tetor 2018 - Tetor 2020], (Rrjeti nacional për t'i dhënë fund dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, 2020), <http://www.glasprotivnasilstvo.org.mk/wp-content/uploads/2021/02/NAP-finalen.pdf>.

përgjegjës koordinues ishte themeluar së fundi. Në përgjithësi nuk ka ndonjë ndryshim pozitiv në këtë fushë.

Ne mund të përfundojmë me siguri se norma e parashikuar për të dhënat statistikore të mbledhura nacionale, publikisht të disponueshme, të detajuara dhe të ndara në mënyrën e duhur nuk është përmbushur. Informacioni ekzistues vetëm lehtësisht e prek temën e DHBGJ dhe DHNG dhe kryesisht prek dhunën në familje si fenomen por rrallëherë apo pothuajse asnjëherë ndonjë formë tjetër të DHBGJ dhe DHNG. Ajo që ishte gjithashtu e rëndësishme për të përmendur është informacioni jetik mbi rastet e DHF dhe DHNG që nuk ka arritur në gjykata (i hedhur poshtë nga prokurori para çdo procedure ligjore) mund të jetë tërësisht i paqasshëm dhe është një segment i rëndësishëm që mund të jap dritë në të dhënat e DHBGJ dhe DHNG dhe ofron një kontekst domethënës analitik që më tutje sqaron situatën e DHBGJ dhe DHNG në Maqedoninë e Veriut. Mungesa e përgjigjes institucionale në kërkesën tonë për informata publike dhe ndryshimet e fundit në legjislacionin nacional (dhe procedurat e papërfunduara për hartimin e akteve nënligjore) e bëjnë sfiduese detyrën për të nxjerr përfundime të informuara për gjendjen aktuale të punëve me mbledhjen e të dhënave në nivel nacional.

Përveç asaj që është theksuar më sipër, disa nga agjencitë vijuese me financim publik gjithashtu mbledhin një pjesë të të dhënave në DHBGJ dhe DHNG (kryesisht në DHF):

- Agjencitë për zbatimin e ligjit / shërbimet e drejtësisë penale dhe civile: policia dhe gjykatat mbledhin të dhëna për rastet e raportuara dhe të përpunuara por nuk ka informata të disponueshme për entitetet tjera për zbatimin e ligjit siç janë shërbimet për ndjekjen penale, burgjet dhe shërbimet e probacionit.
- Shërbimet e kujdesit shëndetësor (për shembull mjekët, shërbimet për aksidente dhe urgjenca, spitalet) – nuk ka informacion nëse këto entitete mbledhin të dhëna për DHBGJ/DHNG dhe cila është forma dhe thellësia që ata ndjekin.
- Shërbimet sociale, mirëqënia sociale dhe shërbimet speciale për viktimat (shtetërore dhe OJQ) mbledhin raporte dhe raste për DHBGJ/DHNG, që kryesisht fokusohet në DHF si lloj më i zakonshëm i DHBGJ/DHNG që është raportuar deri në një shkallë.
- Organet tjera zyrtare që përgjithësisht kanë për detyrë të mbledhin të dhënat siç janë Enti shtetëror për statistika (ESHS) nuk zbulojnë informata për mbledhjen e të dhënave për DHBGJ/DHNG dhe, në pajtim me përgjigjen e tyre zyrtare, ESHS nuk mbledh të dhëna mbi DHBGJ/DHNG

Duke u bazuar në informatat dhe konsultimet e disponueshme me OSHC që janë ekspert të fushës, ka një mungesë evidente të informatave specifike kur bëhet fjalë për DHBGJ dhe një kërkesë të fuqishme për më shumë transparencë dhe burime dhe mekanizma të të dhënave të organizuara më së miri në mënyrë sistematike. Pavarësisht të gjithë përpjekjeve të përfaqësimit të OSHC, kjo mbetet status kuo edhe në vitin 2021.

Për shkak të mungesës të burimeve transparente publike dhe një përgjigje të detajuar dhe në kohë institucionale, OSHC ende mbesin burimi kryesor i informatave mbi të dhënat administrative të DHBGJ/DHNG. Raporti i fundit rajonal nga Fondacioni Kvinna till Kvinna, i hartuar me mbështetje të OSHC lokale dhe i dedikuar për gratë në politikë, dhuna e bazuar në gjini dhe siguria për avokatët për të drejtat e grave në Shqipëri, Bosnjë dhe Hercegovinë, Kosovë, Mali të Zi, Maqedoni të Veriut dhe Serbi, përmbledh



situatën me DHBGJ/DHNG dhe ofron disa statistika të përgjithshme nga agjencitë për zbatimin e ligjit dhe ofruesit e shërbimeve sociale për periudhën 2015-2020.⁹⁵ Aktivitetet dhe hulumtimet e financuara nga donatorët apo të bazuara në projekte ende po zëvendësojnë për pritshmëritë e parapara, por mungojnë iniciativat me financim publik edhe në fushën e mbledhjes të të dhënave mbi DHBGJ dhe DHNG.

Përfundimisht, paragrafi 4 i Nenit 11 përmban detyrimin për të siguruar se informatat e mbledhura janë bërë të disponueshme për publikun. Përderisa ne njohim se ka mbetur një margjinë për palët shtetërore për të përcaktuar formën dhe mënyrat, si dhe llojin e informatave që duhet të jenë në dispozicion, në të tashmen, Republika e Maqedonisë së Veriut nuk është në pajtim me detyrimet e saj të përgjithshme sipas Nenit 11, gjithashtu sipas paragrafit 4.

Rekomandimet:

- Realizoni një anketë të mbështetur nacionale të bazuar në popullsi në interval të rregulltë me qëllim që të vlerësoni mbizotërimin dhe tendencat e të gjithë formave të dhunës të mbuluara nga Konventa e Stambollit.
- Risni kapacitetin dhe zbatimin e dispozitave ligjore që detyrojnë mbledhjen e të dhënave për DHBGJ dhe DHNG sipas ligjit për DHBGJ.
- Përsosni metodat për grumbullimin e të dhënave dhe procedurat që tashmë po zbatohen, në veçanti në lidhje me ndarjen e të dhënave, me qëllim që të mundësohet mbledhja e të dhënave për të gjithë format e dhunës të mbuluara nga fushëveprimi i kësaj Konvente me një pikëpamje në studimin e shkaqeve rrënjësore dhe efekteve, incidenca dhe shkallët e ndëshkimit, si dhe efikasiteti i masave të ndërmarra për të zbatuar këtë Konventë.
- Krijoni mbledhjen sistematike të të dhënave, grumbullimin dhe rregullat dhe praktikat për publikim dhe alokoni financimin e rregullt shtetëror për këtë financim.
- Hartoni dhe miratoni një protokoll për mbledhjen e të dhënave dhe shkëmbimin e të dhënave për Agjencinë maqedonase të informimit.

III – Mbrojtja dhe mbështetja

Neni 20 – Shërbimet e përgjithshme të mbështetjes

Disa shërbime të përgjithshme të mbështetjes janë siguruar nga institucionet publike. Institucionet kryesore publike që sigurojnë këto shërbime janë:

⁹⁵ Kvinna till Kvinna, *Të drejtat e grave në Ballkanin Perëndimor* (2020) http://www.glasprotivnasilstvo.org.mk/wp-content/uploads/2020/11/WRWB_2020.pdf, 65.



- Qendrat për punë sociale: 30 qendra në 30 komuna, 36 zyra rajonale të qendrave për punë sociale në 36 komuna (nga gjithsej 80 komuna) dhe një Institut për çështje sociale.⁹⁶

Ligji mbi mbrotjen sociale⁹⁷ siguron bazën ligjore për disa lloje të ndihmës financiare për njerëzit që janë në rrezik social. Në mënyrë më specifike, të ardhurat e garantuara minimale (varen nga anëtarët e familjes) janë lloji kryesor i ndihmës financiare që mund të merret. Llojet tjera të ndihmës financiare janë parashikuar për njerëzit me lloje të ndryshme të aftësive të kufizuara, familjet me një anëtar, etj. Ky ligj gjithashtu siguron bazën ligjore për ndihmën financiare për akomodim (Neni 27). Ky kompenzim vlen për të gjithë personat që janë financiarisht dhe ekonomikisht të pasigurtë dhe që janë shfrytëzues të të ardhurave minimale të garantuara dhe për personin që ka patur statusin e fëmijës pa prindër dhe pa kujdes prindëror deri në moshën 18 vjeçare, deri në moshën 26 vjeçare. Në pajtim me ligjin e njëjtë, Neni 62 u ofron viktimave të DHF një ndihmë financiare të njëhershme prej 15.000 denarësh për ofrimin e mbrojtjes dhe kujdesit urgjent, dhe deri në 12.000 denarë për kujdes shëndetësor dhe trajtim mjekësor.

- Agjencia e punësimit⁹⁸

Agjencia e punësimit e RMV ofron programe dhe masa aktive për punësim përmes planeve vjetore operative (2015-2020). Edhe pse këto dokumente njohin gratë viktimat si një grup i rrezikuar, masat e propozuara nuk janë të përshtatura me nevojat individuale apo me viktimat dhe janë krijuar për kategoritë e personave në rrezik social. Përveç asaj, mungesa e koordinimit ndërmjet Agjencisë të punësimit dhe qendrave lokale për punë sociale, së bashku me faktin se në praktikë viktimat e DHF nuk regjistrohen në mënyrë specifike në synimin e keq të këtyre masave për viktimat e DHF.⁹⁹

- Institucionet shëndetësore: 14 spitale të përgjithshme, 29 spitale, 11 qendra të kujdesit shëndetësorë, 32 klinika dhe qendra klinike, 9 spitale speciale, 3 institute dhe 3 spitale psikiatrike.¹⁰⁰

Viktimat gra të DHBGJ dhe DHF janë liruar nga obligimi për të paguar pjesëmarrje për shërbimet shëndetësore. Kjo e drejtë edhe pse është rregulluar me Ligjin për mbrojtje shëndetësore ende nuk është zbatuar. Për të arritur këtë të drejtë, viktimat duhet të sigurohet në institucionet e shëndetit publik. Në mënyrë shtesë, të gjithë trajtimet e specialistëve kërkojnë pjesëmarrje nga shfrytëzuesit, prandaj pavarësisht të statusit të sigurimit shëndetësorë, viktimat që janë gra janë të obliguara që të mbulojnë vetë këto

⁹⁶ Lista e qendrave për punë sociale, *Agjencia për mbrojtjen e të drejtës për qasje të lirë në informata të karakterit publik*, <https://aspi.mk/imateli/362/>

⁹⁷ Закон за социјалната заштита [Ligji për mbrojtjen sociale], *Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut*, Nr: 104/2019; 146/2019; 275/2019; 302/2020; 311/2020; 163/2021.

⁹⁸ Uebfaqja zyrtare e Agjencisë për punësim: <https://av.gov.mk/pocetna.nsp.x>.

⁹⁹ Intervistë me përfaqësuesin e Agjencisë për punësim nga monitorimi i raportit në hije.

¹⁰⁰ Lista e institucioneve shëndetësore, *Agjencia për mbrojtjen e të drejtës në qasje të lirë në informata të karakterit publik*, <https://aspi.mk/imateli/5/>



shpenzime. Për më tepër, nëse ata nuk kanë sigurim shëndetësor, ata duhet të mbulojnë shumën e përgjithshme të shërbimit shëndetësor të ofruar.¹⁰¹

Në pjesët vijuese shtesë, ne ofrojmë detaje shtesë mbi shërbimet mbështetëse të përgjithshme disponuese. Ne fokusohemi në: ndihmë sociale, akomodim, ndihmë juridike dhe ndihmë juridike pa pagesë, mbështetje psikologjike, punësim, dhe shërbimet shëndetësore.

a. Ndihma sociale

Ligji mbi mbrojtjen sociale (2019) siguron ndihmën e njehershme financiare për viktimat e DHF deri në 12.000 MKD (200 EUR) (shpenzimet e kujdesit shëndetësor) apo deri në 15,000 MKD (250 EUR) (shpenzimet të akomodimit). Për të dyja, kriteret në ligj nuk janë specifikuar në mënyrë të mjaftueshme “që lejon hapësirë për punëtorët social që të vendosin lirisht se çfarë vlerë mund të pranojë viktimat, dmth. të jepet një vlerë shumë më e ulët se maksimumi i vendosur apo aspak, në rastin e viktimës që është punësuar dhe ka të ardhura mesatare mujore”.¹⁰² Që të dyja nuk mund të konsiderohen si të përshtatshme për të përmbushur nevojat e menjëhershme dhe urgjente të viktimave të DHBGJ, e lerë më për shumë. Kompenzimi financiar për kujdesin shëndetësor mund të jetë i mjaftueshëm vetëm nëse viktimat e DHF mund të përjashtohen “nga pjesëmarrja në shërbimet shëndetësore që lidhen me dhunën dhe ofron kontrolla pa pagesë për viktimat që nuk janë siguruar”,¹⁰³ që nuk janë për momentin.

PNV parasheh aktivitete që do të udhëheqin në promovimin e qasjes të përfitimit të sigurimit social. Megjithatë, viktimat e DHBGJ nuk njihen në mënyrë specifike si kategori për shumë prej këtyre përfitimeve për të filluar. Që është më e rëndësishme, viktimat e DHBGJ nuk janë përmendur shprehimisht se kanë të drejtë në të ardhura të garantuara minimale (kategoritë e përmendura në shprehimisht përfshijnë personin që nuk ka mundësi të punojë për shkak të aftësive të kufizuara intelektuale, aftësisë të kufizuar fizike, sëmundjes mendore apo për shkak të ndryshimeve të përhershme në statusin shëndetësor. Për më tepër, pala shtetërore nuk parasheh lloje të tjera të mbështetjes financiare për gratë viktimat të DHF të cilat janë larguar nga mjedisi i dhunshëm që do u mundësojë atyre të sigurojnë akomodim të qëndrueshëm dhe nevoja tjera të jetës për ato dhe fëmijët e tyre.¹⁰⁴

b. Banimi

Ligji për mbrojtjen shëndetësore parasheh bazat ligjore për sigurimin e kompenzimit për akomodimit për të gjithë personat të cilët nuk kanë akomodim dhe nuk janë të siguruar materialisht, dhe janë përdorues të ndihmës të garantuar minimale dhe personi që deri në moshën 18 vjeçare ka patur statusin e fëmijës pa prindër dhe pa kujdes prindëror (edhe pas ndërprerjes të kujdestarisë, deri në maksimum 26 vjet). Megjithatë, shumica e grave viktimat të dhunës që janë aktualisht në rrezik të mbesin pa strehim kur

¹⁰¹Lista e zyrave rajonale të qendrave për punë sociale. *Ministria e punës dhe politikës sociale*, <https://www.mtsp.gov.mk/disperzirani-oddelenija-na-centrite-za-socijalna-rabota.nspk>.

¹⁰²Rrjeti nacional për t'i dhënë fund dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, *Hulumtimi themelor: shërbimet ekzistuese për rehabilitim dhe integrim të ofruara në nivel lokal në Republikën e Maqedonisë së Veriut* (2020), <http://www.glasprotivnasilstvo.org.mk/wp-content/uploads/2021/01/Baseline-research-design-eng-1.pdf>, 9.

¹⁰³Po aty.

¹⁰⁴Po aty.

braktisin mjedisin e dhunshëm nuk përmbusin kushtet ligjore për përfitimin e kësaj të drejte. Kjo i len ato që të zgjidhin çështjen e akomodimit të tyre me ndihmë të njëhershme financiare deri në MKD 15,000 (rreth 250 EUR) për sigurimin e mbrojtjes dhe kujdesit urgjent.

Sipas Ligjit për banim, kriteret për të përfituar banesë pa pagesë janë ato me të ardhura të ulëta, personat e rinj që qëndrojnë në zonat e caktuara, çiftet e rinj të martuar, familjet me një prind, të pensionuarit mbi 60 vjet të cilët nuk kanë apartament dhe kategoritë tjera të njerëzve në rrezik social (Neni 91). Sidoqoftë, ky ligj gjithashtu nuk përfshin viktimat e DHBGJ si një kategori e veçantë që ka të drejtë në banesë pa pagesë. Pala shtetërore nuk ofron lloje tjera të mbështetjes financiare për gratë viktimat të dhunës në familje të cilët kanë braktisur mjedisin e dhunshëm dhe kanë shpenzime financiare të lidhura me qeranë dhe shpenzimet e regjisë.

Thirrja e fundit për banesat sociale e publikuar nga Qeveria e Maqedonisë së Veriut¹⁰⁵, nuk përfshin shprehimisht viktimat e DHBGJ si kandidat të përshtatshëm për banesa sociale. Kandidatët e përshtatshëm janë identifikuar si fëmijë pa prindër / kujdes prindëror, njerëzit që përdorin fondet minimale për mbrojtje sociale, njerëzit e ndikuar nga katastrofat natyrore, njerëzit me aftësi të kufizuara, romët dhe famijet me një prind.

Me mbështetjen e Qytetit të Shkupit, Rrjeti nacional për dhënien fund të dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje në mars të vitit 2020, ka ndërtuar një shtëpi të hapur të banimit që akomodon gratë viktimat të dhunës dhe fëmijët e tyre dhe merr mbështetje me qëllim që të arrihet riintegrimi dhe rehabilitimi i tyre i plotë. Ky shërbim ofron banesën e hapur apo tranzit nga momenti që gratë viktimat dhe fëmijët e tyre braktisin mjedisin e dhunshëm derisa ata të integrohen tërësisht në jetën sociale. Gjithashtu ofrohet mbështetje psikologjike dhe këshillim, si dhe ndihma për punësim përmes promovimit të shkathtësive të punës dhe arsimit. Ky model i banimit është realizuar përmes mbështetjes të drejtëpërdrejtë të punëtorit social që ofron shërbime sociale dhe këshillimit për realizimin e të drejtave sociale, duke e lidhur atë me shërbimet tjera të specializuara për gratë viktimat të dhunës në familje, dhe ndihmës në ofrimin e shërbimeve sociale në fushën e mbrojtjes sociale, shëndetësore dhe fëmijërore, dhe sigurimin e një programi individual për riintegrimin dhe rehabilitimin e viktimave që do të jetojnë në banesa.

c. Ndihmë juridike

PNV parasheh përfshirjen e viktimave të dhunës në familje si përdorues të ndihmës juridike pa pagesë në Ligjin për ndihmë juridike pa pagesë. Në vitin 2019, me miratimin e Ligjit të ri për ndihmë juridike pa pagesë, viktimat e DHF ishin prezantuar si një kategori e veçantë e përdoruesve të ndihmës juridike pa pagesë. Ky ligj parasheh ndihmën ligjore në procedurat për mbrojtjen nga dhuna, shkurorëzimi dhe nevojat tjera ligjore, por për këto procedura vlera e të ardhurave është vlerësuar gjithashtu në vendimmarrje. Në pajtim me nenin 20 të Ligjit për ndihmë juridike pa pagesë, ndihma dytësore juridike duhet të ofrohet pa përcaktuar situatën financiare nëse aplikanti është vendosur në një familje përkujdesëse, njësi banimi për

¹⁰⁵ Qeveria e Maqedonisë së Veriut, “Оглас за распределба на 37 социјални во Струмица” [Shpallja për shpërndarjen për banesa sociale për Qytetin e Strumicës], *Faqja zyrtare e internetit e qeverisë të Maqedonisë së Veriut*, <https://vlada.mk/node/25007>. Përderisa kjo shpallje është në mënyrë specifike për Strumicën, monitorët tonë kanë informata se ka të bëjë me disa komuna në Maqedoninë e Veriut.



jetesë të organizuar me mbështetje apo në institucionin për mbrojtje sociale, me vendim të Qendrës për punës sociale ose, nëse aplikanti duhet të iniciojë dhe përfaqësojë në procedurë për shqiptimin e masave të përkohshme për mbrojtje nga DHF para gjykatës kompetente.

Aplikanti për ndihmë juridike pa pagesë duhet të dorëzojë një certifikatë se ato janë të regjistruar si viktime të DHF. Kjo shkakton sfida në praktikë për dy arsye kryesore. Së pari, ligji nuk specifikon formën, apo institucionin kompetent për lëshimin e kësaj certifikate. Së dyti, qendrat për punë sociale, ku viktimat e DHBGJ dhe DHF mund të raportojnë rastet e dhunës në familje, shpesh refuzojnë që të lëshojnë certifikate të tillë që thekson “se nuk është dëshmuar” se dikush është viktimë e DHF. Kjo ishte shënuar si shkak për shqetësim gjithashtu në vëzhgimet më të fundit përfunduese të CEDAW.¹⁰⁶

Ndihma juridike pa pagesë është thelbësore për gratë që kanë mbijetuar dhunën sepse procedurat administrative dhe gjyqësore janë shpesh të gjata, komplekse, dhe të shtrenjta, dhe viktimave u nevojitet ndihmë ligjore që të kenë mundësi të ushtrojnë të drejtat e tyre. Në praktikë, ky lloj i shërbimeve ofrohet kryesisht përmes OSHC, por gjithashtu përmes qendrave për punë sociale. Sipas informacionit të disponueshëm, ka gjithsej 14 OJQ që ofrojnë shërbime juridike pa pagesë për gratë që janë viktime të dhunës në familje.¹⁰⁷ Zakonisht ofrimi i ndihmës juridike pa pagesë kryesisht i referohet rasteve të DHF. Gratë që janë viktime nuk janë përkufizuar në mënyrë specifike si shfrytëzues të ndihmës juridike pa pagesë, por varet nga situata e tyre financiare, dmth. fakti nëse është rrezikuar mbështetja e tyre personale dhe mbështetja e familjes të tyre që jeton në ekonominë e njëjtë familjare dhe përmbushja e kushteve tjera. Përfitimi i vetëm ekziston vetëm për viktimat e DHF, por jo edhe për viktimat e DHNG, është se të ardhurat e personave që kërkojnë ndihmë juridike pa pagesë mund të vlerësohen individualisht, nëse ka konflikt të interesave familjare për të cilat kërkohet ndihma juridike pa pagesë (Neni 12(5)).

d. Mbështetja psikologjike

Në lidhje me sigurimin e qendrave për këshillim të specializuar për viktimat e dhunës në familje, Ministria e punës dhe politikës sociale ka themeluar 2 qendra të këshillimit për viktimat në kryeqytet – Shkup, dhe 7 qendra në Tetovë, Prilep, Manastir, Ohër, Kavadar, Shtip dhe Kumanovë, të menaxhuara nga qendrat për punë sociale.

e. Punësimi

Shërbimet dhe masat për mbështetjen e punësimit nuk janë zhvilluar në mënyrë që i bën ata të përshtatshme për nevojat individuale të viktimave¹⁰⁸ dhe të realitetit se viktimat e DHF shpesh funksionojnë si familje me një prind, sidomos në situatat kur ka një apo më shumë fëmijë të mitur (mosha parashkollore)

¹⁰⁶ Komisioni për eliminimin e diskriminimit ndaj grave: *Vëzhgimet përfunduese për raportin e gjashtë periodik të ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë CEDAW/C/MKD/CO/6* (14.11.2018), para.13(a).

¹⁰⁷ Ministria e drejtësisë, *Регистар на здруженија за бесплатна правна помош* [Regjistri i shoqatave për ndihmë juridike pa pagesë], <https://www.pravda.gov.mk/bpp>.

¹⁰⁸ Rrjeti nacional për t'i dhënë fund dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, *Препораки за унапредување на можностите за вработување на жени жртви на семејно насилство* [Udhëzimet për avancimin e mundësive për punësim për gratë që janë viktime të dhunës në familje] (2020), <http://www.glasprotivnasilstvo.org.mk/wp-content/uploads/2020/12/Operativni-planovi-web.pdf>.



(që shpesh rezulton në nevojën për arranzhime më fleksibile të punës të cilat përmbushen vështirë). Ata gjithashtu janë kufizuese dhe nuk janë të disponueshme për të gjithë gratë dhe zakonisht nuk marrin parasysh kushtet që lindin (dmth monitorimi i situatës dhe përshtatja e masave ekzistuese apo propozimi i masave të reja).¹⁰⁹

Viktimat e DHF janë pjesë e grupeve të synimit të planeve operative dhe masave aktive për punësim të shtetit (siç është transferimi i kushtëzuar i parave të gatshme, trajnimi në vendin e punës, punësimi i subvencionuar).¹¹⁰ Sidoqoftë, kjo është një mundësi vetëm për gratë viktime të DHF dhe vetëm për qytetarët e regjistruar në Agjencinë e punësimit si kërkues aktiv të punës.¹¹¹ Këto politika nuk mbulojnë popullsinë joaktive që përbëhet kryesisht nga gratë (54% sipas Entit shtetëror për statistika). Kjo më tutje nuk merr parasysh realitetin e grave nga zonat rurale dhe komunitetet etnike që kryesisht trajnohen se janë ekonomikisht joaktiv.¹¹² Programet për vetëpunësim nuk janë të përshtatura në aspekt të nivelit dhe llojit të mbështetjes të siguruar për nevojat e parashikuara të viktimave të DHBGJ dhe DHF.¹¹³ Në përgjithësi, situata dhe pozita e viktimave të DHBGJ dhe DHF gjithashtu nuk është marrë parasysh kur bëhet fjalë për rritjen e nevojës për mbështetjen dhe këshillimin nga palët e treta (siç janë personat nga shërbimet sociale).¹¹⁴

f. Shërbimet shëndetësore

Neni 51 i Ligjit për DHBGJ parasheh detyrimin e institucioneve për kujdes shëndetësor. Shumica prej tyre janë detyrime të menjëhershme dhe përfshijnë kontrollin dhe trajtimin e menjëhershëm shëndetësorë, dokumentimin e lëndimeve, dhe mbledhjen e dëshmive për shkeljen e integritetit trupor dhe psikologjik, lëshimi i dokumentacionit mjekësor për lëndimet e dokumentuara duke përfshirë përshkrimet e qarta, informimin e viktimave për të drejtat e tyre dhe procedurat për mbrojtje dhe shërbimet e disponueshme për ndihmë dhe mbështetje, si dhe masat tjera. Kompenzimi financiar për kujdesin shëndetësor mund të jepet për të përmbushur nevojat e menjëhershme për viktimat e DHF, meqenëse ata janë përjashtuar “nga

¹⁰⁹ Po aty.

¹¹⁰ Po aty.

¹¹¹ Закон за вработувањето и осигурување во случај на невработеност [Ligji për punësim dhe sigurim në rast të papunësisë], *Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë*, Nr.37/1997; 4/1998; 14/1999; 25/2000; 101/2000; 50/2001; 7/2002; 25/2003; 37/2004; 4/2005; 50/2006; 29/2007; 88/2007; 102/2008; 161/2008; 162/2008; 50/2010; 88/2010; 171/2010; 51/2011; 86/2011; 11/2012; 80/2012; 114/2012; 39/2014; 44/2014; 44/2014; 113/2014; 56/2015; 129/2015; 147/2015; 154/2015; 27/2016; 119/2016; 21/2018; 113/2018; *Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut*, Nr.124/2019; 103/2021.

¹¹² Ministria e punës dhe politikës sociale, *Национална стратегија за вработување на Република Македонија 2016-2020* [Strategjia nacionale për punësim e Republikës së Maqedonisë 2016-2020], <https://www.mtsp.gov.mk/content/pdf/strategii/Nacionalna%20Strategjija%20za%20Vrabotuvane%20na%20Republika%20Makedonija%20za%20Vlada%2016102015.pdf>.

¹¹³ Rrjeti nacional për t'i dhënë fund dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, *Препораки за unapreduvanje na можностите за вработување на жени жртви на семејно насилство* [Udhëzimet për avancimin e mundësive për punësim për gratë që janë viktime të dhunës në familje] (2020), <http://www.glasprotivnasilstvo.org.mk/wp-content/uploads/2020/12/Operativni-planovi-web.pdf>.

¹¹⁴ Po aty.



pjesëmarrja në shërbimet shëndetësore që lidhen me dhunën dhe ofron kontrolla pa pagesë për viktimat që nuk janë të siguruar”,¹¹⁵ që nuk janë për momentin.

PNV kërkon që viktimat e DHBG të përfshihen në Programin e Ministrisë të shëndetësisë për nënat dhe fëmijët dhe në Programin për heqjen e tarifave deri në fund të vitit 2018. Kjo ishte zbatuar vetëm pjesërisht, sepse programi i mëparshëm ishte ndryshuar, por jo i fundit. Programi për mbështetjen e nënave dhe fëmijëve për vitin 2019 përfshin kontrollat mjekësore pa pagesë dhe shërbimet tjera për gratë që janë viktimat të dhunës seksuale që nuk kanë kujdes shëndetësor, megjithatë nuk përfshin format tjera të DHBGJ.¹¹⁶

Rekomandime:

- Njihni viktimat e dhunës të bazuar në gjini si një kategori e veçantë që ka të drejtë në të ardhura të garantuara minimale sipas Ligjit për mbrojtje sociale.
- Përfshijni viktimat nga pjesëmarrja në shërbimet shëndetësore që lidhen me dhunën dhe ofroni kontrolla pa pagesë për viktimat e pasiguruara.
-
- Rishikoni kushtet për sigurimin e kompenzimit për banesë me qëllim që të pasqyrojë realitetin e situatës të shumicës të grave që largohen nga dhuna.
- Shtoni viktimat e DHBGJ e DHF në kategoritë që kanë të drejtë për banesë pa pagesë. Ndryshoni Ligjin për ndihmë juridike pa pagesë me qëllim që të njihen viktimat e DHBGJ, jo vetëm të DHF, si shfrytëzues të ndihmës juridike pa pagesë.
- Ndryshoni Ligjin për ndihmë juridike pa pagesë për të specifikuar formën dhe institucionin (et) kompetente që kanë për detyrë të lëshojnë certifikata të tilla.
- Ndiurma dhe shërbime punësimi që mund të përshtaten në nevojat e viktimave të DHBGJ dhe DHF duhet të zhvillohen përmes bashkëpunimit të Agjencisë të punësimin, qendrave për punë sociale dhe OSHC.
- Programet për vetëpunësim duhet të përshtaten në aspekt të shumës dhe llojeve të mbështetjes të ofruar (siç është mbështetja e rritur për mentorim).
- Programi për heqjen e pagesave për pjesëmarrje duhet të përfshijë viktimat e DHBGJ dhe DHF.

¹¹⁵ Rrjeti nacional për t'i dhënë fund dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, *Hulumtimi themelor: ekzistimi i shërbimeve të rehabilitimit dhe integritit të ofruara në nivel lokal në Republikën e Maqedonisë së Veriut* (2020), <http://www.glasprotivnasilstvo.org.mk/wp-content/uploads/2021/01/Baseline-research-design-eng-1.pdf>, 9.

¹¹⁶ Maja Balshikjeska dhe Ana Avramovska Nushkova, *Извештај за напредокот на Р. Северна Македонија при спроведувањето на Националниот акциски план за имплементација на Истанбулската конвенција - октомври 2018 - октомври 2020* [Raport për zbatimin e Planit nacional të veprimit për zbatimin e Konventës të Stambollit në Maqedoninë e Veriut - Tetor 2018 - Tetor 2020], (Rrjeti nacional për t'i dhënë fund dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, 2020), <http://www.glasprotivnasilstvo.org.mk/wp-content/uploads/2021/02/NAP-finalen.pdf>.



- Programi për mbrojtjen e nënave dhe fëmijëve duhet të parashoh shërbime për të gratë që janë DHBGJ, pavarësisht llojit të dhunës dhe statusit të sigurimit shëndetësor.

Neni 22 – Shërbimet e specializuara për mbështetje

Shtrirja dhe cilësia e shërbimeve të ofruara duket se dallon në mënyrë të konsideruar. Përderisa zyrtarisht ofruesit e shërbimeve nuk janë në mungesë të stafit, duket sikur ka mungesë të profesionistëve të trajnuesve në dispozicion të profesionistëve që punojnë me DHF/DHBGJ.¹¹⁷

Këto shërbime janë ofruar shpesh në strehimore dhe qendrat e krizës. Në Maqedoninë e Veriut ka 13 qendra të tilla: dhjetë strehimore dhe tre qendra të krizës. Pesë prej tyre menaxhohen nga OSHC të grave dhe të tjerat nga Ministria e punës dhe politikës sociale (MPPS). Dhjetë shërbimet janë për viktimat e DHF (prej të cilëve 9 janë të hapura nga MPPS). Ka 8 qendra në të cilat viktimat mund të marrin këshillim (prej të cilave një themeluar nga MPPS). Ka tre qendra të krizave për viktimat e dhunës seksuale (deri në 72 orë) të cilat menaxhohen nga Ministria e shëndetësisë në Shkup, Tetovë dhe Kumanovë. Në përgjithësi, Ministria e punës dhe politikës sociale financon katër OSHC të cilat ofrojnë shërbime të specializuara për gratë viktimat të DHBGJ dhe DHF.¹¹⁸

Çështja kryesore mbetet shpërndarja gjeografike e qendrave strehimore dhe sigurimi i shërbimeve tjera (siç është mbështetja ligjore dhe psikologjike) sepse shumica e strehimore janë të lokalizuara në disa qytete më të mëdha që janë jashtë qasjes të grave nga zonat e largëta.¹¹⁹ Ata menaxhojnë një kapacitet me 101 shtretër, që është 50% e kapacitetit të kërkuar në pajtim me udhëzimet e Konventës të Stambollit. Kjo mungesë e shtretërve përhapet më tej në padisponueshmërinë e shërbimeve mbështetëse të specializuara për viktimat. Përveç kësaj, ata nuk funksionojnë në një mënyrë holistike që do të adresojnë diskriminimin ndërseksional me të cilin përballen viktimat e DHBGJ dhe DHF. Mungesa e qasjes ndërseksionale në dizajnin dhe zbatimin e këtyre masave ndikon në mënyrë të konsideruar te gratë tradicionalisht të përjashtuara, gratë e tilla me aftësi të kufizuara, trans gratë, gratë që përdorin drogë, dhe gratë që janë punëtore seksi.

Përveç asaj, në pajtim me ligjin për DHBGJ, njësitë e vetëqeverisjes lokale (komunat dhe Qyteti i Shkupit) janë përgjegjëse për “sigurimin e mbrojtjes për viktimat në komunitetin lokal, themelimi i qendrave të kujdesit, qendrat për këshillimin e viktimave dhe qendrat e këshillimit të dhunës në familje, prindërit dhe këshillimi i fëmijëve, qendrat e këshillimit dhe format tjera për kujdes dhe ndihmë të viktimave, duke përfshirë linjat SOS” (Neni 33).

¹¹⁷ Kvinna till Kvinna, *Women’s Rights in the Western Balkans* (2020) http://www.glasprotivnasilstvo.org.mk/wp-content/uploads/2020/11/WRWB_2020.pdf.

¹¹⁸ Ministria e punës dhe politikës sociale, përgjigje në pyetjen për qasje të lirë në informata të karakterit publik, nr arkivës.14-4493/6 (27.07.2021).

¹¹⁹ Intervista e ekspertit të OSHC; Kvinna till Kvinna, *Të drejtat e grave në Ballkanin Perëndimor* (2020) http://www.glasprotivnasilstvo.org.mk/wp-content/uploads/2020/11/WRWB_2020.pdf; HERA, *2020 Raporti vjetor – Mbështetja e të rrezikuara në kohëra të krizës, mbrojtja e të drejtave sociale dhe riprodhuese!* (HERA, 2020), https://hera.org.mk/wp-content/uploads/2021/06/Godishen-izveshtaj-za-2020-godina_en-web.pdf, 21.

Rekomandimet:

- Siguroni qasje praktike dhe të standardizuar për të gjithë shërbimet të specializuara për mbështetje për të gjithë gratë, në veçanti gratë me aftësi të kufizuara, gratë rome dhe gratë migrante/azilkërkuese.
- Ka nevojë për të zgjeruar kapacitetin e strehimoreve për viktimat e DHBGJ dhe DHF në aspekt të shtretërve.
- Shpërndarja gjeografike dhe disponueshmëria e strehimoreve duhet të rritet.

Neni 23 – Strehimoret

Numri i strehimoreve që mund të ofrojnë akomodim të sigurtë për viktimat e DHBGJ dhe DHF në Maqedoninë e Veriut është 13 – dhjetë strehimore dhe tre qendra të krizës. Pesë janë të udhëhequra nga OSHC të grave dhe të tjerat nga Ministria e punës dhe politikës sociale (MPPS). Dhjetë shërbimet janë për viktimat e DHF (prej atyre 9 që janë hapur nga MPPS). Ka gjithsej tre qendra të krizës për viktimat e dhunës në familje (deri në 72 orë) të menaxhuara nga Ministria e shëndetësisë në Shkup, Tetovë dhe Kumanovë. Në përgjithësi, Ministria e punës dhe politikës sociale financoon katër OSHC që ofrojnë shërbime të specializuara për gratë që janë viktimat të DHBGJ dhe DHF.¹²⁰

Çështja kryesore mbetet numri i pamjaftueshëm i qendrave të strehimit, shpërndarja gjeografike dhe sigurimi i shërbimeve tjera (siç është ndihma ligjore pa pagesë dhe mbështetje psikologjike).¹²¹ Shpërndarja gjeografike është sfidë meqënëse shumica e strehimoreve janë lokalizuar në disa qytete më të madhe dhe të paarrtshme për gratë nga zonat e largëta.¹²² Ata menaxhojnë një kapacitet me 101 shtretër, që është 50% e kapacitetit që nevojitet në pajtim me udhëzimet për Konventën e Stambollit. Kjo mungesë e shtretërve shpërndahet mbi padisponueshmërinë e shërbimeve tjera për viktimat që nuk mund të gjejnë strehim këtu. Përveç asaj, ata nuk operojnë në mënyrë holistike që do të adresojë diskriminimin ndërseksional me të cilin përballen viktimat e DHBGJ dhe DHF.

Shtirja dhe cilësia e shërbimeve të siguruara duket se varet në mënyrë të konsideruar. Përderisa zyrtarisht ofruesit e shërbimeve kanë mungesë të të punësuarëve, duket sikur ka mungesë të profesionistëve të trajnuar të disponueshëm për të ofruar mbështetje 24/7. Megjithatë, ka mungesë të përgjithshme të trajnimit të vazhdueshëm të specializuar të disponueshëm për profesionistët që punojnë me

¹²⁰ Ministria e punës dhe politikës sociale, përgjigje në pyetjen për qasje në informata të karakterit publik, numri i arkivës.14-4493/6 (27.07.2021).

¹²¹ Në vëzhgimet e tij përfunduese, Komisioni i CEDAW ka rekomanduar këtë: “Risni numrin e strehimoreve, dhe siguroni që qasja për gratë që janë viktimat të dhunës me bazë gjinore është në kuadër të distancës të arsyeshme, dhe të shërbimeve të këshillimit dhe rehabilitimit në palën shtetërore dhe siguroni se gratë dhe vajzat që janë viktimat të dhunës me bazë gjinore kanë qasje të plotë dhe pa pengesa në mbështetjen mjekësore dhe psikologjike.” Burimi: Komisioni mbi eliminimin e diskriminimit ndaj grave, *Vëzhgimet përfunduese në raportin e gjashtë periodik të ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë CEDAW/C/MKD/CO/6* (14.11.2018), para.24(g).

¹²² Interviste e ekspertit të OSCH; Kvinna till Kvinna, *Të drejtat e grave në Ballkanin Perëndimor* (2020) http://www.glasprotivnasilstvo.org.mk/wp-content/uploads/2020/11/WRWB_2020.pdf; HERA, *Raporti vjetor 2020 – Mbështetja e të rrezikuara në kohën e krizës, mbrojtja e të drejtave sociale dhe riprodhuese!* (HERA, 2020), https://hera.org.mk/wp-content/uploads/2021/06/Godishen-izveshtaj-za-2020-godina_en-web.pdf, 21.



DHF/DHBGJ.¹²³ Për më tepër, përveç se për një, strehimoret nuk janë të qasshme për personat me aftësi të kufizuara, siç është vëzhguar nga Komisioni për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara.¹²⁴

Përveç asaj, sipas ligjit për DHBGJ, njësitë e vetëqeverisjes lokale (komunat dhe qyteti i Shkupit) janë përgjegjës për “siigurimin e mbrojtjes për viktimat në komunitetin lokal, themelimin e qendrave për kujdes, qendrat për këshillim për viktimat dhe qendrat për këshillim të dhunës në familje, prindërit dhe këshillimi i fëmijëve, qendrat e këshillimit dhe format tjera për kujdes dhe ndihmë të viktimave, duke përfshirë linjat SOS” (Neni 33).

Rekomandimet:

- Ka nevojë për zgjerimin e kapacitetit të strehimoreve për viktimat e DHBGJ dhe DHF në aspekt të shtretërve.
- Shpërndarja gjeografike dhe disponueshmëria e strehimoreve duhet të rritet.
- Këto strehimore duhet të jenë të qasshme për të gjithë gratë, në veçanti gratë me aftësi të kufizuara, gratë rome dhe gratë migrante/azilkërkuese.

Neni 24 – Linjat ndihmëse telefonike

Ligji për DHBGJ përshkruan masat që janë të parashikuara për lehtësimin e raportimit të DHBGJ dhe DHF nga qytetarët (Neni 12, 33). Ka 3 linja të ndihmës të S.O.S që ofrojnë mbështetje 24/7. Në mënyrë shtesë, ka një linjë të ndihmës të përkushtuar për viktimat/të mbijetuarit e trafikimit të njerëzve. Linjat e ndihmës janë të udhëhequra nga OSCH të grave.

Linjat e ndihmës mbesin gjërësisht të paqasshme për gratë të cilët nuk flasin gjuhën maqedonase që është gjuhë e shumicës. Vetëm një linjë ndihmëse ofron mbështetje të kufizuar në gjuhën shqipe, përderisa nuk ekziston asnjë linjë për shërbime ndihmëse në gjuhët tjera të pakicave etnike.

Në vitin 2020, gjatë valës të parë të KOVID -19, Ministria e punës dhe politikës sociale kanë realizuar një fushatë të financuar nga OSBE mbi parandalimin dhe mbrojtjen nga DHF. Përmes fushatës të Ministrisë që synon të informojë viktimat e DHF, por gjithashtu edhe publikun e gjërë për atë se si të njohin të gjithë format e DHF, ku të kërkojnë dhe raportojnë për ndihmë dhe cilët janë shërbimet ekzistuese për mbrojtjen e viktimave të DHF. Ministria ka inkurajuar viktimat e DHF, por të gjithë ata që kanë qënë dëshmitarë apo kanë njohuri për dhunën, të raportojnë në linjat ekzistuese të SOS, stacioni më i afërt politik, qendrat për

¹²³ Kvinna till Kvinna, *Të drejtat e grave në Ballkanin Perëndimor* (2020) http://www.glasprotivnasilstvo.org.mk/wp-content/uploads/2020/11/WRWB_2020.pdf.

¹²⁴ Komisioni për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara, *Vëzhgimet përfundimtare të raportit fillestar të ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë CRPD/C/MKD/CO/1* (29.10.2018), para.28(c).



punë sociale, institucionet shëndetësore, ashtuqë ata mund të kërkojnë mbrojtje nga kryerësi dhe mbështetje të mëtutjeshme.¹²⁵

Rekomandimet:

- Prezantoni ose mbështetje financiare të OSHC për të hapur dhe menaxhuar linjat e ndihmës në gjuhët përveç asaj maqedonase dhe shqipe dhe përmirësoni qasshmërinë e linjave të ndihmës në gjuhën shqipe.

Neni 25 – Mbështetja për viktimat e dhunës në familje

Ka tre qendra të krizës për viktimat e dhunës seksuale (deri në 72 orë) të menaxhuar nga Ministria e shëndetësisë në Shkup, Tetovë dhe Kumanovë.¹²⁶ Megjithatë, kjo nuk është e mjaftueshme në numër, as mund të konsiderohet përkatëse dhe lehtësisht e qasshme.

Rekomandimet:

-Zgjerimi i rrjetit të qendrave përkatëse, lehtësisht të qasshme të përdhunimit apo dhunës seksuale apo qendrat referuese të dhunës seksuale për viktimat në numra të mjaftueshëm që mund të ofrojë për shqyrtimin mjekësor dhe forenzik, mbështetja traumatike dhe këshillimi për viktimat. Siguroheni që zgjerimi i këtij rrjeti mundëson qasshmëri gjeografike në të gjithë territorin e shtetit dhe se shërbimet e ofruara nga këto qendra janë të qasshme për viktimat nga grupet etnike që nuk janë shumicë në shtet dhe për gratë me aftësi të kufizuara.

IV – E drejta materiale (substanciale)

Neni 29 – Paditë civile dhe mjetet juridike

Korniza ligjore e zbatueshme, si tërësi, është mjaftë e re, dhe kështu mbetet të shihet nëse mjetet juridike civile do të dëshmojnë nëse janë përkatëse në praktikë për kontekstin e veçantë. Ligji i vitit 2014 për DHF ka siguruar mundësinë për mbrojtjen e përkohshme të viktimave të DHF. Pas kërkesave të viktimave, gjykatat mund të marrin vendimin për të ndalur kryerësin që të vazhdojë me dhunën, të kontaktojë viktimat apo mund të prezantojë masa tjera që do të parandalojnë paraqitjen e dhunës. Ligji për DHBGJ, që ka zëvendësuar ligjin e DHF të vitit 2014, përcakton masat e njëjta të përkohshme për viktimat e DHBGJ. Disa

¹²⁵ Intervista e ekspertit të OSHC.

¹²⁶ Ministria e punës dhe politikës sociale, përgjigje për kërkesën për qasjen në informata të karakterit publik, nr I arkivës.14-4493/6 (27.07.2021).



elemente, siç është mundësia e qartë ligjore për të inicuar procedurë civile për shkeljen e kujdesit të duhur respektivisht analizës të thellë (para ekzistimit vetëm si pjesë e elementit të urgjencës), janë të reja. Gjetjet nga monitorimi duket se sygjerjnë se masat më të vjetra janë më të ushtruara në praktikë krahasuar me të rejat.

Deri tani, duket se gjykatat po përdorin mundësinë për mbrojtje të përkohshme, në lidhje me ligjin e DHBGJ. Në periudhën janar-maj 2021 kishte 171 kërkesa për mbrojtje civile dhe ishin miratuar 123 kërkesa.¹²⁷ Numri i masave të imponuara mbi kryerësit në periudhën e përkatëse nuk mund të konstatohet sepse në shumicën e procedurave, viktimat theksojnë më shumë se një masë dhe gjykatata imponojnë disa masa me një vendim. Vetëm gjykata në Ohër dhe Tetovë ka siguruar të dhëna të ndara për formën e dhunës nga e cila viktimat ka kërkuar mbrojtje. Kështu, në Ohër gjithë 13 pretendimet ishin për mbrojtjen nga dhuna fizike dhe në Tetovë nga 12 nga pretendime, 4 ishin për mbrojtje ndaj dhunës psikologjike dhe 8 për mbrojtjen nga dhuna fizike. Gjykata në Shkup ka siguruar të dhëna të ndara mbi llojin e masave që ka imponuar gjykata për kryerësin. Nga gjithsej 44 masa, në dy raste gjykata ka urdhëruar largimin e kryerësit nga shtëpia. Gjykatat në Gostivar dhe Strugë nuk kanë pranuar ndonjë kërkesë për masat e përkohshme mbrojtëse në periudhën e caktuar.

Në lidhje me mbrojtjen civile të viktimave në rastet kur institucionet shtetërore kanë dështuar në detyrën e tyre për të ndërmarrë masat e nevojshme parandaluese apo mbrojtëse në kuadër të kompetencave të tyre, mundësia ligjore për të iniciuar procedurë civile për shkeljen e kujdesit të duhur respektivisht analizës së thellë nuk ishte inicuar përballë gjykatave në periudhën janar - maj 2021. Për periudhën e njëjtë, gjykatat në Gostivar dhe Kavadar kanë raportuar vetëm një rast të akuzës për vrasje të një gruaje. Në periudhën e njëjtë gjykata në Ohër ka marrë aktgjykim mbi vrasjen e një gruaje dhe kryerësi është dënuar me 2 vjet burg.

Rekomandimet:

- Zhvilloni dhe realizoni një program trajnimi për praktikantët ligjor me qëllim të promovimit të mundësive për mjetet juridike civile për viktimat e DHBGJ dhe DHF.
- Të avancohen më tutje kapacitetet për mbledhjen e të dhënave dhe procedurat e gjykatave, në veçanti ndarjen e të dhënave, me qëllim që të kuptojnë më së miri përdorimin e mjeteve juridike civile.

Neni 30 – Kompenzimi

As korniza aktuale juridike e zbatueshme dhe as rrishtë e shpallura apo diskutuara deri tani do të sjellin Maqedoninë e Veriut në pajtim me detyrimet e saj sipas nenit 30. Mundësitë aktuale për kompenzim sipas ligjit janë veçanërisht kufizuese.

Ligji për procedure penale parasheh bazat ligjore për kompenzimin e dëmeve nga fondet shtetërore për viktimat e veprave penale për të cilat Kodi penal parasheh minimum katër vite të burgimit. Sidoqoftë, vetëm

¹²⁷ Ne kemi përfutur të dhënat e prezantuara në këtë pjesë përmes kërkesave për qasje në informata publike të cilat ne i kemi dorëzuar në 15 gjykata të shcallës të parë. Nga këto, ne nuk kemi marrë përgjigje vetëm nga këto tre gjykata – gjykatat në Gjevgjeli, Strumicë dhe Shtip.



viktimat e mitura të trafikimit me qenie njerëzore, sulmit seksual dhe përdhunimit mund të marrin kompensim nga fondet shtetërore, pasiqë të shteren të gjithë mjetet për ekzekutimin e aktgjykimit përfundimtar të gjykatës. Kjo e drejtë është e garantuar me Ligjin për të drejtat e fëmijëve. Në periudhën janar-maj 2021 nuk kishte kërkesë për kompensim të dorëzuar në Ministrinë e drejtësisë dhe vetëm dy fëmijë të sulmit seksual kanë marrë kompensim nga fondi.

Ka një proces të vazhdueshëm për hartimin e Ligjit për pagesën e kompensimit monetar për viktimat e veprave penale. Neni 9 i draftit përfshin DHBGJ si vepër e dhunshme penale që bën pjesë në kuadër të fushëveprimit të ligjit të propozuar. Gjithashtu parasheh kompensimin për viktimat e drejtëpërdrejta dhe të tërthorta, siç janë bashkëshortët, partnerët, fëmijët, prindërit, gjyshërit,¹²⁸ që mund të jenë të rëndësishme në rastet e DHBGJ dhe DHF. Kushtëzimi i mundësisë për të kërkuar regres për kompensimin e dhënë nga kryerësi duke u bazuar në detyrimin në lidhje me pagesën e bërë për sigurinë e viktimave nuk është adresuar mirë në projektligj. Megjithatë, projektligji do të sjellë në përgjithësi një përmirësim të kornizës ligjore krahasuar me atë aktuale. Por, miratimi i këtij ligji, që është pritur për fundin e vitit 2019, është shtyrë në mënyrë të konsideruar.¹²⁹

Përfundimisht, rezerva e palës shtetërore në paragrafin 2 mbetet në zbatim. Sipas kësaj rezerve, Maqedonia e Veriut, “rezervon të drejtën që të mos e zbatojë ose ta zbatojë vetëm në raste të caktuara dispozitat e Nenit 30, paragrafi 2, të Konventës, në pajtim me legjislacionin e tij të zbatueshëm (Ligji mbi drejtësinë e fëmijëve) vetëm në lidhje me fëmijët të cilët kanë qenë viktimat me vendimin përfundimtar të Gjykatës apo të jenë të lënduar nga akti që është përcaktuar me ligj si vepër penale me elemente të dhunës”.¹³⁰ Kjo mund të paraqes sfidë për procesin e zgjerimit të kompensimit dytësor shtetëror për ata që nuk janë shtetas, siç është kërkuar nga Konventa e Stambollit, duke marrë në konsideratë kufizimet e paraqitura nga Neni 3(3) të Ligjit për drejtësi të fëmijëve. Kështu, përderisa rezervat e këtij neni janë të mundshme, qasja për rezervat duhet të rikonsiderohet me qëllim të sigurimit të kompensimit për të gjithë fëmijët.

Rekomandimet:

- Miratoni një ligj që mundëson që kompensimi të jepet për ata që kanë përjetuar lëndime serioze trupore apo dëmtim të dëgjimit, në shkallën që dëmtimi nuk është mbuluar nga burimet tjera siç është kryerësi, sigurimi apo shëndetësia e financuar nga shteti dhe dispozitat sociale.
- Prezantoni garanca se mundësia për të kërkuar regres për kompensimin e dhënë nga kryerësi do të kushtëzohet në pagesën e detyrimit në lidhje me sigurinë e viktimës.

¹²⁸ Предлог закон за исплата на паричен надоместок на жртви од кривични дела [Propozimiligi për pagesën e kompensimit në para për viktimat e veprave penale] (16.09.2019), ENER, https://ener.gov.mk/Default.aspx?item=pub_regulation&subitem=view_reg_detail&itemid=54834.

¹²⁹ Në kohën e shkrimit të këtij raporti, propozimi për Ligjin për pagesën e kompensimit në para për viktimat e veprave penale është miratuar në Qeveri (28.07.2021). Tani do të dërgohet për diskutim dhe miratim në Parlament. Burimi: Qeveria e Republikës të Maqedonisë së Veriut, 92 седница на Владата [séance e 92 e Qeverisë], *Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut, Gazeta zyrtare*, <https://vlada.mk/node/26044>.

¹³⁰ Këshilli i Evropës, *Rezervat dhe deklaratat, CETS, No.210*, <https://www.coe.int/en/web/conventions/full-list/-/conventions/treaty/210?module=declarations-by-treaty&numSte=210&codeNature=0>



- Merrni në konsideratë modifikimin e rezervës që është në paragrafin 2 me qëllim që të lejohet kompensimi për të gjithë fëmijët, që janë apo nuk shtetas të Maqedonisë.

Neni 33 – Dhuna psikologjike

Veprimi i qëllimshëm i dëmtimit serioz të integritetit psikologjik të një personi përmes shtrëngimit apo kërcënimeve nuk është inkriminuar në Maqedoninë e Veriut. Kjo formë e dhunës është përfshirë në përkufizimin e dhunës në familje të përfshirë në Nenin 122(21) të Kodit penal që përkufizon DHF si “ngacmim, ofendim, rrezikim të sigurisë, lëndim trupor, seksual apo psikologjik, dhunës fizike apo ekonomike që shkakton ndjenjën e pasigurisë, kërcënimit apo frikës, duke përfshirë kërcënimin e veprimeve të tilla, drejtë bashkëshortes, prindërve apo fëmijëve apo personave tjerë që jetojnë në bashkësinë martesore dhe jashtëmartesore apo ekonomisë të përbashkët familjare, si dhe drejtë bashkëshortit aktual apo të mëparshëm apo partnerit jashtëmartesor apo personat që kanë fëmijë të përbashkët apo janë në marrëdhënie të ngushta personale, pavarësisht nëse kryerësi ndan apo ka ndarë vendbanimin e njëjtë me viktimën apo jo”.¹³¹ Megjithatë, dhuna psikologjike nuk është formë e dhunës *per se* jashtë sferës të dhunës në familje. Kjo e bën të pamundur për të ndjekur rastet e DHBGJ të përkushtuara përmes dhunës psikologjike. Përveç kësaj, përkufizimi i DHF prezanton elementin e të shkaktuarit “të ndjenjës të sigurisë, kërcënimit apo frikës” që mund të interpretohet si një element shtesë që duhet të përmbushet para gjykatës. Një element i tillë nuk është i pranishëm në Nenin 33, as në Nenin 3 (b), të Konventës të Stambollit.

Rekomandimet:

- Kriminalizoni dhunën psikologjike, të përkufizuar si veprim të qëllimshëm për dëmtimin serioz të integritetit psikologjik të personit përmes shtrëngimit apo kërcënimit, si formë e veçantë e dhunës në Kodin penal.
- Harmonizoni përkufizimin e dhunës në familje me Nenin 3(b) të Konventës të Stambollit.

Neni 34 – Ndjekja

Ndjekja, e nënkuptuar si veprim i qëllimshëm i angazhimit të përsëritur në veprimet kërcënuese të drejtuara drejtë personit tjetër, duke i shkaktuar asaj apo atij të ketë frikë për sigurinë e tij apo të saj, nuk është inkriminuar. Në fakt, ndjekja nuk është njohur aspak me sistemin nacional juridik. Prezantimi i përkufizimit të kësaj vepre penale në Kodin Penal është pjesë e objektivit 1 të PNV, të planifikuar për përfundim deri në

¹³¹Кривичен законик [Kodi penal], *Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë*, Nos. 80/1999; 48/2001; 4/2002; 16/2002; 43/2003; 19/2004; 40/2004; 81/2005; 50/2006; 60/2006; 73/2006; 87/2007; 7/2008; 139/2008; 114/2009; 51/2011; 51/2011; 135/2011; 185/2011; 142/2012; 143/2012; 166/2012; 55/2013; 82/2013; 14/2014; 27/2014; 28/2014; 41/2014; 41/2014; 115/2014; 132/2014; 160/2014; 199/2014; 196/2015; 226/2015; 97/2017; 170/2017; 248/2018. Neni.122(21).



fund të vitit 2019.¹³² Në kohën e hartimit të këtij raporti në hije,¹³³ një propozim për ndryshimin e Kodit penal që ishte miratuar nga Qeveria do të prezantohet ndjekjen si vepër penale.¹³⁴ Propozimi për ndryshimet e Kodit penal do të shkojnë për diskutim dhe miratim në Parlament.

Rekomandimet:

- Prezantoni veprën penale të ndjekjes, të nënkuptuar si një veprim i qëllimshëm i angazhimit të përsëritur në veprimin kërcënues të drejtuar ndaj personit tjetër, duke bërë që ai apo ajo të frikësohet për sigurinë e tij apo të saj, në Kodin penal.

Neni 35 – Dhuna fizike

Veprimi i qëllimshëm i kryerjes të akteve të dhunës fizike kundër personit tjetër është inkriminuar. Neni 130 i Kodit penal inkriminon lëndimin trupor, ndërsa Neni 131 inkriminon lëndimin e rëndë trupor. Që të dy krimet janë të përgjithshme dhe nuk janë të formuluar në mënyrë që mund të marrë në konsideratë natyrën me bazë gjinore të veprave penale, sa i përket Konventës të Stambollit. Për të dy veprat, ndëshkimi më i rëndë është përshkruar në rastet e dhunës në familje, por kjo nuk përfshin të gjithë rastet e DHBGJ. Gjithashtu, nuk mbulon në tërësi natyrën me bazë gjinore të veprave penale dhe as që lejon mbledhjen përkatëse të të dhënave për veprat penale ku DHF vepron si kualifikues, në kundërshtim me nenin 11 të Konventës të Stambollit.¹³⁵

Përveç asaj, Maqedonia e Veriut bërë një rezervë në këtë nen, në lidhje me neni 55, paragrafi 1 (ex officio dhe ex parte) në pajtim me të cilin shteti e rezervon të drejtën “të mos zbatohet nenin 55, paragrafi 1 në lidhje me nenin 35 të kësaj Konvente në lidhje me veprat penale më pak të rrezikshme, deri në harmonizimin e dispozitave të legjislacionit relevant të Republikës së Maqedonisë me dispozitat e

¹³² Ministria e punës dhe politikës sociale, Акциски план за спроведување на Конвенцијата за спречување и борба против nasilstvoto врз жените и семејното nasilstvo на Република Македонија 2018-2023 [Plani i veprimit për zbatimin e Konventës për parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje në Republikën e Maqedonisë 2018-2023], <https://mtsp.gov.mk/content/word/oglasj/New%20node/Финал%20драфт%20НАП%20ИК%202018-2023.02.docx>; Закон за спречување и заштита од nasilstvo врз жените и семејното nasilstvo [Ligji për parandalimin dhe mbrojtjen e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje], *Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut*, Nr.24/2021.

¹³³ Teksti i mbyllur në 10.08.2021.

¹³⁴ Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut, 92 седница на Владата [séanca e 92-të të Qeverisë], *Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut*, <https://vlada.mk/node/26044>.

¹³⁵ Marija Risteska dhe Aleksandar Cekov, *Анализа на потребите од усогласување на Кривичниот законик со Истанбулската конвенција во Република Северна Македонија* [Analiza e nevojave për harmonizimin e Kodit Penal me Konventën e Stambollit në Republikën e Maqedonisë së Veriut], (Qendra për hulumtim dhe krijim të politikave dhe lobi i grave maqedonase, 2019), 27.

Konventës aktuale.”¹³⁶ Kjo që është interpretuar si vënie në zbatim të Konventës të Stambollit në lidhje me dhunën fizike është praktikisht e pamundur.¹³⁷

Rekomandimet:

- Merrni në konsideratë rishikimet e Kodit penal që do të mundësojnë njohjen e natyrës me bazë gjinore të dhunës fizike në rastet e DHBGJ dhe DHF.
- Merrni në konsideratë rishikimet e Kodit penal që do të mundësojnë mbledhjen e të dhënave, sa i përket nenit 11 të Konventës të Stambollit.
- Rezerva në zbatimin e nenit 55, paragrafi 1, në lidhje me nenin 35 duhet të tërhiqen.

Neni 36 – Dhuna seksuale duke përfshirë përdhunimin

Qasja drejtë dhunës seksuale, duke përfshirë përdhunimin, në sistemin nacional ligjor është ndryshe nga ajo që është përshkruar në Konventën e Stambollit. Elementi më qëndror që mungon në qasjen drejtë kësaj veprë penale është pajtimi. Neni 186 i Kodit penal përshkruan veprimin e “përdhunimit” të përkufizuar se kryhet “përmes përdorimit të forcës apo kërcënimit të një sulmi të menjëhershëm në jetën apo trupin e dikujt, apo një sulm në jetën apo trupin e një personi të afërt.” Edhe nëse disa prej elementeve mund të lexohen si mungesë e pajtimit, kjo nuk është e njëjta sikurse dhënia e pajtimit “vullnetarisht si rezultat i vullnetit të lirë të personit”. Për më tepër, përkufizimi gjithashtu përfshin elementet e “dhunimit të detyrueshëm” (në gjuhën maqedonase “*присили на обљуба*”) që prezanton një fokus të fuqishëm në sjelljen e viktimës, duke përfshirë elementin ku viktimja duhet të dëshmojë dhënien e rezistencës (që është diskutuar gjërësisht në literaturë si element i rëndësishëm i çdo përkufizimi të përdhunimit). Sanksioni është denim me burg prej tre deri në dhjetë vjet. Ky nen është paraparë më tutje për rastet e përdhunimit të personit të mitur (14 deri në 18 vjet) (paragrafi 2, dhe denim me burg prej të paktën dhjetë vjet), lëndim të rëndë trupor, vdekje apo pasoja tjera të rënda që rezultojnë nga përdhunimi apo nëse vepra penale “ishte kryer nga disa persona apo në mënyrë veçanërisht mizore dhe degraduese apo për shkak të urrejtjes, kryerësi duhet të sanksionohet me të paktën denim me burg prej katër vitesh” (paragrafi 3). Ky përkufizim nuk është tërësi në pajtim me tekstin dhe shpirtin e Konventës të Stambollit. Ky përkufizim gjithashtu ishte

¹³⁶ Këshilli i Evropës, *Rezervat and deklarimet, CETS, No.210*, <https://www.coe.int/en/web/conventions/full-list/-/conventions/treaty/210?module=declarations-by-treaty&numSte=210&codeNature=0>

¹³⁷ Marija Risteska dhe Aleksandar Sekov, *Анализа на потребите од усогласување на Кривичниот законик со Истанбулската конвенција во Република Северна Македонија* [Analiza e nevojave për harmonizimin e Kodit penal me Konventën e Stambollit në Republikën e Maqedonisë së Veriut], (Qendra për hulumtim dhe krijim të politikave dhe lobi i grave maqedonase, 2019), 9.



sfiduar nga vëzhgimet më të fundit përfunduese të Komisionit të CEDAW.¹³⁸ Kodi penal inkrimonon¹³⁹ në mënyrë të ngjajshme veprimet e sulmit seksual të personit të pamundur (Neni 187), sulmi seksual i personit të mitur më të ri se 14 vjet (neni 188), dhe sulmi seksual përmes keqpërdorimit të pozitës të pushtetit (Neni 189). Nuk përfshin një referencë të veçantë për veprimet e kryera kundër bashkëshortëve apo partnerëve të mëparshëm apo të tashëm, sipas paragrafit 3 të Nenit 26.

Rekomandimet:

- Harmonizoni përkufizimet e dhunës seksuale, duke përfshirë përdhunimin, në legjislacionin nacional me nenin 36 të Konventës të Stambollit, duke siguruar qartazi rëndësinë e pajtimit të dhënë vullnetarisht si rezultat i vullnetit të lirë të personit të vlerësuar në kontekst të rrethanave të mjedisit si një element të këtyre përkufizimeve.

Neni 37 – Martesat e detyrueshme

Martesa e detyrueshme, si veprim i qëllimshëm i detyrimit të personit madhor apo fëmijës që të hyjë në martesë nuk është inkriminuar në Kodin penal. Neni 418-a dhe 418-g përfshijnë martesën e detyrueshme në inkriminimin e trafikimit të personave dhe trafikimit të fëmijëve. Neni 197 ndalon bashkëjetesën me një fëmijë më të ri se 16 vjet (apo deri në 18 vjet pas propozimit). Megjithatë, asnjë prej tyre nuk fokusohet në martesën e detyrueshme për se, siç është paraparë sipas nenit 37 të Konventës të Stambollit. Prezantimi i përkufizimit të kësaj vepre penale në Kodin penal është pjesë e objektivit 1 të PNV, të planifikuar për përfundim deri në fund të vitit 2019.¹⁴⁰ Megjithatë, ky aktivitet ende nuk është përfunduar.

Rekomandimet:

- Prezantoni veprën penale të martesës të detyrueshme, si veprim të qëllimshëm të detyrimit të një personi madhor apo një fëmijë që të hyjë në martesë, në Kodin penal.

¹³⁸ Komisioni për eliminimin e diskriminimit ndaj grave, *vëzhgimet përfunduese në raportin e gjashtë periodik të ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë CEDAW/C/MKD/CO/6* (14.11.2018), para.24(c).

¹³⁹ Veprat tjera penale të natyrës seksuale përfshijnë masturbimi para një personi tjetër ("Përmbushja e nevojave (pasioneve) seksuale përpara personit tjetër" Neni 190), ndërmjetësimi në prostitucion (Neni 191), shfaqja e materialeve pornografike para një fëmijë (Neni 193), prodhimi dhe shpërndarja e pornografisë të fëmijëve (Neni 193-a), nxitja e fëmijës që nuk ka mbushur 14 vjet në sulm seksual apo në veprim tjetër seksual (përmes mënyrave të komunikimit me kompjuter) (Neni 193-b) dhe incesti (Neni 194). Burimi: Кривичен законик [Kodi penal], *Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë*, Nr. 80/1999; 48/2001; 4/2002; 16/2002; 43/2003; 19/2004; 40/2004; 81/2005; 50/2006; 60/2006; 73/2006; 87/2007; 7/2008; 139/2008; 114/2009; 51/2011; 51/2011; 135/2011; 185/2011; 142/2012; 143/2012; 166/2012; 55/2013; 82/2013; 14/2014; 27/2014; 28/2014; 41/2014; 41/2014; 115/2014; 132/2014; 160/2014; 199/2014; 196/2015; 226/2015; 97/2017; 170/2017; 248/2018.

¹⁴⁰ Ministria e rripës dhe politikës sociale, Akciski plan за спроведување на Конвенцијата за спречување и борба против nasiltството врз жените и семејното nasiltstvo на Република Македонија 2018-2023 [Plani i veprimit për zbatimin e Konventës për parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje në Republikën e Maqedonisë 2018-2023], <https://mtsp.gov.mk/content/word/oglasi/New%20node/Финал%20драфт%20НАП%20ИК%202018-2023.02.docx>.



Neni 38 – Gjymtimi gjenital femëror

Prerja (heqja), infibulimi apo kryerja e çfarë gjymtimi tjetër të gjithë pjesës apo një pjese të labia majora të gruas , labia minora apo klitorisits, shtrëngimi apo marrja e një gruaje, apo nxitja, shtrëngimi apo marrja e një vajze për veprimet e njëjta nuk është inkriminuar në Maqedoninë e Veriut. Prezantimi i përkufizimit të kësaj vepre penale në Kodin penal është pjesë e objektiviti 1 të PNV, të planifikuar për përfundim deri në fund të vitit 2019.¹⁴¹ Megjithatë, ky aktivitet i PNV ende nuk është përfunduar.

Rekomandimet:

- Prezantoni veprën penale të gjymtimit gjinor, sipas nenit 38 të Konventës të Stambollit, në Kodin Penal.

Neni 39 – Aborti i detyrueshëm dhe sterilizimi i detyrueshëm

Realizimi i abortit ndaj një gruaje pa pajtimin e saj paraprak dhe të informuar dhe realizimi i një operimi që ka për qëllim apo efekt të ndërpres kapacitetin e një gruaje që të riprodhojë në mënyrë natyrale pa pajtimin e saj paraprak dhe të informuar apo të kuptuarit e procedurës nuk është inkriminuar në Maqedoninë e Veriut. Prezantimi i përkufizimit të kësaj vepre penale në Kodin penal është pjesë e objektiviti 1 të PNV, të planifikuar për përfundim deri në fund të vitit 2019.¹⁴² Megjithatë, ky aktivitet ende nuk është përfunduar.

Rekomandimet:

- Prezantoni një vepër penale të abortit të detyrueshëm dhe sterilizimit të detyrueshëm, sipas nenit 39 të Konventës të Stambollit, në Kodin penal.

¹⁴¹ Ministria e punës dhe politikës sociale, Акциски план за спроведување на Конвенцијата за спречување и борба против nasilstvoto врз жените и семејното nasilstvo на Република Македонија 2018-2023 [Plani i veprimit për zbatimin e Konventës për parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje në Republikën e Maqedonisë 2018-2023], <https://mtsp.gov.mk/content/word/oglasj/New%20node/Финал%20драфт%20НАП%20ИК%202018-2023.02.docx>.

¹⁴² Ministria e punës dhe politikës sociale, Акциски план за спроведување на Конвенцијата за спречување и борба против nasilstvoto врз жените и семејното nasilstvo на Република Македонија 2018-2023 [Plani i veprimit për zbatimin e Konventës për parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje në Republikën e Maqedonisë 2018-2023], <https://mtsp.gov.mk/content/word/oglasj/New%20node/Финал%20драфт%20НАП%20ИК%202018-2023.02.docx>.



Neni 40 – Ngacmimi seksual

Veprimi i padëshiruar verbal, jo-verbal apo fizik i natyrës seksuale dhe në çdo formë me qëllimin apo efektin e shkeljes të dinjitetit të personit, në veçanti kur krijohet mjedis frikësues, armiqësorë, degradues, poshtërues apo mjedis ofendues nuk është inkriminues me ligjin nacional.¹⁴³ Gjithashtu është subjekt i sanksioneve të ndryshme ligjore, të cilët gjithashtu bëjnë pjesë në fushëveprimin e nenit 40 të Konventës të Stambollit. Ngacmimi seksual në Ligjin për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi, Ligji mbi ngacmimin në vendin e punës dhe Ligji për mundësi të barabarta të burrave dhe të grave. Këto janë tre aktet kryesore legjislative që merren me barazinë dhe mosdiskriminimin, dispozitat mbi ngacmimin seksual mund të gjenden të shpërndara edhe në ligje tjera. Këto përkufizime nuk janë gjithmonë në pajtim me atë nga *lex generalis* – Ligji për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi.

Sipas nenit 10(2) të Ligjit për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi, “Ngacmimi seksual duhet të nënkuptojë veprimin e padëshiruar verbal, jo-verbal apo fizik të natyrës seksuale që ka për qëllim apo efekt shkeljen e dinjitetit apo krjimin e mjedisit, qasjes apo praktikës kërcënuese, armiqësore, poshtëruese apo frikësuese.” Ky përkufizim përfshin të gjithë elementet kryesore nga përkufizimi i nenit 40 të Konventës të Stambollit. Neni 41 i vetëm dhe në lidhje me nenin 42 (për format më të rënda të diskriminimit, duke përfshirë diskriminimin e shumëfishtë dhe ndërseksional) parasheh dënim në para nga 400 në 3.000 EUR (Neni 41) dhe nga 700 deri 5.000 EUR (neni 42). Përkufizimi në nenin 4(7) në Ligjin për mundësi të barabarta të burrave dhe grave është i ngajshëm me atë në Ligjin për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi. Ligji për ngacmim në vendin e punës është specifik në fushëveprimin e tij në atë që nuk lidh veprimet e ngacmimit me bazën e diskriminimit. Është ende relevante për qëllimet e ngacmimit seksual dhe për harmonizimin me Konventën e Stambollit. Neni 5(2) nga ky ligj ndjek në masë të madhe elementet e kërkuara nga Konventa e Stambollit.¹⁴⁴

Rekomandimet:

- Harmonizoni të gjithë dispozitat nacionale mbi ngacmimin seksual me përkufizimin e dhënë në nenin 10(2) të Ligjit për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi.
- Prezantoni sanksionet penale për veprën penale të ngacmimit seksual siç është përkufizuar në nenin 40 të Konventës të Stambollit.

¹⁴³ Ju lutemi vini re, megjithatë, se neni 190 i Kodit penal përfshin veprën penale të masturbimit përballë personit tjetër (“Përmushja e nevojave (pasioneve) seksuale para personit tjetër”), që mund të konsiderohet si një formë e ngacmimit seksual. Burimi: Кривичен законик [Kodi penal], *Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë*, Nr. 80/1999; 48/2001; 4/2002; 16/2002; 43/2003; 19/2004; 40/2004; 81/2005; 50/2006; 60/2006; 73/2006; 87/2007; 7/2008; 139/2008; 114/2009; 51/2011; 51/2011; 135/2011; 185/2011; 142/2012; 143/2012; 166/2012; 55/2013; 82/2013; 14/2014; 27/2014; 28/2014; 41/2014; 41/2014; 115/2014; 132/2014; 160/2014; 199/2014; 196/2015; 226/2015; 97/2017; 170/2017; 248/2018.

¹⁴⁴ Është me rëndësi të theksohet se neni 5 (2) fokusohet vetëm në krijimin e “frikës, dhimbjes, apo poshtërimit” ndërsa neni 40 i Konventës të Stambollit për “mjedisin frikësues, rrezikues, degradues, poshtërues.” Megjithatë, në praktikë, nuk duhet të pritet që kjo do të kufizojë fushëveprimin e mbrojtjes ligjore.



Neni 41 – Ndihma ose nxitja dhe tentativa

Në Kodin penal, “tentativa” është rregulluar me Nenin 19, që thekson se një person që me dashje fillon të kryejë veprën penale, por nuk e përfundon atë, do të ndëshkohet për tentativë të veprës penale për të cilën mund të shqiptohet dënim me burg prej pesë vitesh apo më shumë, dhe për tentativë të një veprë tjetër penale vetëm kur ligji shprehimisht parasheh ndëshkim për tentativë. Kryerësi do të ndëshkohet për tentativë në kuadër të kufijve të sanksionit të parashikuar për veprën penale, dhe mund të ndëshkohet me butë.

Në Kodin penal “nxitja” është rregulluar në nenin 23 si një rregull e përgjithshme për të gjithë veprat penale. Ai përcakton se personi që me dashje nxit personin tjetër që të kryejë vepër penale duhet të ndëshkohet sikur ta ketë kryer vetë. Personi që me dashje nxit personin tjetër që të kryejë vepër penale për të cilën me ligj është paraparë dënim me burg deri në pesë vjet apo dënim më i rëndë, dhe nuk do të jetë bërë tentativë për atë vepër penale, do të ndëshkohet për tentativë të veprës penale.

Neni 24 i Kodit penal përkufizon “ndihmësin” si person që me dashje ndihmon personin tjetër në kryerjen e veprës penale dhe i cili do të ndëshkohet sikur të ketë kryer vetë veprën penale, dhe gjithashtu mund të ndëshkohet me butë. Ndihma në kryerjen e veprës penale përfshin në veçanti: dhënien e këshillave apo instruksioneve për atë se si të kryhet vepra penale, të bëhen të disponueshme mjetet për kryerësin që të kryejë veprën penale, heqjen e pengesave që të kryhet vepra penale, si dhe premtimin paraprak të fshehjes të veprës penale të kryerësit të veprës penale, mjetet me të cilat është kryer vepra penale, gjurmët e veprës penale apo objektet e përfutuara me veprën penale. Gjithashtu është nen i përgjithshëm për të gjithë veprat penale.

Rekomandimet:

- Siguroni që amendamentet e Kodit penal për prezantimin e veprave të reja penale, siç është sygjëruar në këtë raport, parashohin se kemi të bëjmë me vepër penale, kur është kryer me dashje, duke ndihmuar apo nxitur kryerjen e veprës penale të paraparë në pajtim me nenet 33, 34, 35, 36, 37, 38.a dhe 39 të Konventës të Stambollit. Siguroni të njëjtën për tentativat për të kryer veprat penale të parapara në pajtim me nenet 35, 36, 37, 38.a dhe 39 të Konventës të Stambollit.

Neni 43 – Kryerja e veprave penale

Veprat penale të parapara me Kodin penal zbatohen pavarësisht natyrës të marrëdhënies ndërmjet viktimës dhe kryerësit. Duke patur parasysh këtë, është e rëndësishme se të gjithë veprat penale të kërkuara nga Konventa e Stambollit janë të inkriminuara.



Rekomandimet:

- Siguroni që të gjithë veprat penale, siç janë përshkruar nga Konventa e Stambollit, janë inkriminuar sipas legjisllacionit nacional.

Neni 45 – Sanksionet dhe masat

Përderisa formulimi i sanksioneve me ligjin nacional mund të jetë në pajtim me Konventën e Stambollit, duke marrë në konsideratë sfidat për sundimin e ligjit në Maqedoninë e Veriut,¹⁴⁵ vështirë se mund të konsiderohet se sanksionet e parashikuara me ligjin nacional janë efektive dhe zbindëse. Kultura e krijuar e tolerancës për DHBGJ dhe DHF¹⁴⁶ ushqen një klimë të përgjithshme të pandëshkueshmërisë të rasteve të DHBGJ dhe DHF, të cilët nga ana tjetër, i bëjnë këto sanksione zbindëse. Kështu, këto sanksione nuk mund të shihen në mënyrë të veçantë nga sfidat e përgjithshme që formësojnë kontekstin në të cilin janë zbatuar.

Sanksionet e parapara përfshijnë privimin nga liria. Veprat penale të parapara me Kodin penal deri tani i bëjnë veprat penale të parapara me Konventën e Stambollit, të përshtatshme për ekstradim, sipas Ligjit për bashkëpunim ndërkombëtar në të drejtën penale.¹⁴⁷

Në ligjin për DHBGJ ka masa urgjente dhe të përkohshme. Sipas nenit 57, masat urgjente të mbrojtjes janë ndërmarrë me qëllim të eliminimit të rrezikut të menjëhershëm dhe serioz për jetën dhe integritetin fizik dhe psikologjik të viktimës dhe anëtarëve të saj të familjes. Këto përfshijnë largimin e kryerësit nga shtëpia dhe ndalesë që ai t'i qaset shtëpisë. Masat e përkohshme të mbrojtjes janë të mbuluara me nenin 58 për qëllimet e adresimit të arsyeve për kryerjen e sërishme të dhunës. Për këtë qëllim, gjykata mund të imponojë këto masa të përkohshme: 1) ndalesë në kërcënimin për kryerjen e dhunës; 2) ndalesë për ngacmim, kërkim përmes telefonit, kontaktimit apo komunikim tjetër të drejtëprëdrejtë apo të tërthortë të viktimës; 3) ndalesë për qasje në distancë prej më pak se 100 metrash nga vendbanimi, shkolla, vendi i punës apo vendi i caktuar në të cilin merr pjesë rregullisht viktimja; 4) largimi nga shtëpia pavarësisht pronësisë për dhjetë deri në 30 ditë; 5) ndalesa për të zotëruar armë të zjarrit 6) të rikthehen artikujt e nevojshëm për të përmbushur nevojat ditore të viktimës dhe të familjes; 7) të ofrojë mbështetje ligjore për familjen; trajtim të detyrueshëm të kryerësit nëse ai konsumon alkohol, drogë, dhe substanca psikotrope apo ka sëmundje mendore; 10) kryerësi duhet të refundojë shpenzimet mjekësore dhe shpenzimet tjera që janë shkaktuar si rezultat i dhunës; 11) çdo masë tjetër të cilën gjykata e konsideron të nevojshme për të siguruar sigurinë dhe mirëqënien e viktimës dhe anëtarëve tjerë të familjes. Masat e përfshira në nenin 45(2) të Konventës të Stambollit mund të konsiderohen se bëjnë pjesë në kuadër të këtij neni. Komisioni i CEDAW ka shprehur shqetësim në lidhje me mungesën e mbledhjes të të dhënave sistematike “të ndara nga faktorët relevant, në rastet e dhunës me bazë gjinore dhe diskriminimi kundër grave si procedurë

¹⁴⁵ Shihini për shembull: Iva Conevska dhe Ismail Kamberi, *Kapitulli 23 Raporti në hije* (European Policy Institute – Skopje, 2019).

¹⁴⁶ Siç është diskutuar në hyrje të këtij raporti.

¹⁴⁷ Закон за меѓународна соработка во кривичната материја [Ligji për bashkëpunimin ndërkombëtar në të drejtën penale], *Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut*, Nr.77/2021.



gjyqësore dhe numri i urdhërave për mbrojtje të përkohshme dhe përfshijnë të dhënat e tilla në periudhën e ardhshme raportuese.”¹⁴⁸

Rekomandimet:

- Adresoni klimën e përgjithshme të pandëshkueshmërisë të rasteve të DHBGJ dhe DHF për të nxitur efektivitetin dhe zbindjen ndaj sanksioneve për DHBGJ dhe DHF.

Neni 46 – Rrethanat rënduese

Kodi penal vendos rregulla të caktuara të përgjithshme për sanksionim kur mbulohet një pjesë e rrethanave të caktuara rënduese të ofruara nga neni 46, dmth është paraparë se gjykata do të marr parasysht të gjithë rrethanat që ndikojnë që sanksionimi të jetë më i ulët apo më i lartë (zbutja dhe rrethanat rënduese). Një sanksion më i rëndë është specifikuar në kontekst të DHF për këto vepra penale: neni 123 paragrafi 2 (vrasja), neni 125 (vrasja në çast), vrasja 130 paragrafi 2 (lëndim trupor), neni 131 paragrafi 2 (lëndimi i rëndë trupor), neni 139 paragrafi 2 (shtrëngimi), neni 140 paragrafi 2 (privimi i kundërligjshëm i lirisë), neni 144 paragrafi 2 (rrezikimi i sigurisë), neni 188 paragrafi 2 (Sulmi seksual ndaj personit të mitur të moshës nën 14 vjeçare), neni 191 paragrafi 4 (Ndërmjetësimi në prostitucion). Kjo qartazi lë veprimet e DHBGJ dhe veprimet tjera që janë të pranishme të mos jenë të përfshirë me Kodin penal.

Rekomandimet:

- Siguroni që amendamentet e ardhshme të Kodit penal, siç janë propozuar në këtë raport dhe në shkallë të madhe të propozuara me PNV, mbajnë zbatueshmërinë e rrethanave rënduese për të gjithë veprat penale të parapara në bazë të Konventës të Stambollit.

Neni 48 – Ndalimi procedurave apo sanksioneve të detyrueshme për zgjidhjen alternative të kontesteve

Duke u bazuar në Nenin 86 të DHBGJ, në procedurat për mbrojtjen e të drejtave të viktimave gjykata nuk mund t’i referohet palëve për marrëveshje për rezultatin e këtij rasti. Megjithatë, Ligji për procedurë penale

¹⁴⁸ Komiteti për eliminimin e diskriminimit ndaj grave, *Vëzhgimet përfunduese mbi raportin e gjashtë periodik të ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë CEDAW/C/MKD/CO/6* (14.11.2018), para.24(e).



ofron mundësi për kryerësit për marrëveshje me prokurorinë publike dhe viktima nuk ka të drejtë që të deklarohet në proces.

Rekomandimet:

- Largoni shprehimisht mundësinë në Ligjin për procedure penale që kryerësi të bëjë marrëveshje me prokurorin publik, duke përjashtuar viktimën.